

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6053
E premte, 3 korrik 2020
çmimi 0.40 €

BE-ja i dhuron Kosovës 6 000 teste për Covid-19

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EMRUSH UJKANI | FAQE 4-5

DEKLARIMET E SHBA-së PËR LIBERALIZIM TË VIZAVE DO TË NDIKOJNË TE BE-ja



Njohësi i integriteteve evropiane, Emrush Ujkani, ka shprehur optimizëm se çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën do t'i jepet epilog gjatë presidencës gjermane të Këshillit të BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ngritja e zërit të ShBA-së për këtë çështje do ta ketë ndikimin e vet. Ujkani ka bërë me dije se liberalizimi i vizave me Republikën e Kosovës është i një rëndësie të veçantë për besueshmërinë e Bashkimit Evropian në raport me Kosovën.

Rasti Mehmetaj, ministri Selimi i dërgon letër Apostolovës

Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, përmes një letre i ka bërë thirrje shëfës së Zyrës së BE-së në Kosovë - përfaqësueses së posaçme të BE-së, Nataliya Apostolova, që ta përdorë fuqinë diplomatike për t'i bindur autoritetet e Serbisë që ta përdorin Marrëveshjen për Ndhimë Juridike që është nënshkruar ndërmjet vendeve tona me mbështetjen e BE-së rreth rastit të Nezir Mehmetaj që mbahet në Serbi nën akuzë të rreme e të motivuara politikisht



Gara në zgjedhjet e Maqedonisë zhvillohet mes katër koncepteve politike



INTERVISTË ME VEPRIMTARIN E ÇËSHJES KOMBËTARE DHE ISH-USHTARIN E UÇK-SË, ISAK TUSHA

OPINION

30 VJET PAS AMBASADAVE,
KEQARDHJA MË E MADHE
ËSHTË QË NUK U LARGOVA F. 11

Denion
NDRENIKA



AKTUALE



VETERANËT PROTESTOJNË
MË 9 KORRIK ME MOTON
"NË MBROJTJE TË LUFTËS
ÇLIRIMTARE" F. 11

NDËRRON JETË BABI I HEROIT
AFRIM ZHITIA, OSMAN ZHITIA F. 7

DELEGATËT E 2 KORRIKUT
KËRKOJNË PËRKUJDESJE
INSTITUCIONALE F. 7

EKONOMI

GPLS-JA: KOSOVA DUHET TA
KETË NJË PLAN TË GJELBËR
PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE F. 8

SINDIKATA E SEKTORIT PRIVAT
SHPREH SHQETËSIM PËR
MOSPAGESËN E PUNËTORËVE
NGA QEVERIA F. 8

SPORT

BUTRINT AHMETIT I DUHET
NËNSHTETËSIA SHQIPTARE PËR TA
VAZHDUAR KARRIERËN NË EVROPË F. 16

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Cakaj: Liberalizimi i vizave është i një rëndësie thelbësore për Kosovën dhe BE-në

TIRANË, 2 KORRIK (ER) - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Shqipërisë, Gent Cakaj, ka reaguar pas marrjes së Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian nga Gjermania, duke thënë se mbështetja gjermane mbetet jetike për proceset integruese të Ballkanit Perëndimor.

Cakaj në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se, krahas zgjerimit të BE-së, liberalizimi i vizave ka rëndësi jetike për qytetarët e Kosovës dhe BE-në. "Gjermania tashmë ka marrë Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian (BE)! Përderisa nën presidencën kroate është arritur vendimi historik për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, me presidencën Gjermane do të punojmë fort e

ngushtë për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare. Mbështetja e Gjermanisë ka qenë jetike për politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor: me Presidencën gjermane të Këshillit, ndërkaq do të punojmë për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe kryerjen e të gjitha detyrimeve të nevojshme për përparimin e mëtejshëm në procesin e anëtarësimit në BE. Vlen të theksohet se liberalizimi i vizave me Republikën e Kosovës është i një rëndësie thelbësore, jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe për besueshmërinë e Bashkimit Evropian (BE) në rajon në përgjithësi! Shqipëria do ta vazhdojë me përkushtim të plotë punën e pakursyer për anëtarësim në BE!", ka shkruar Cakaj.



Hoti bisedon me kancelarin e Austrisë: Kosova, e gatshme për dialog



PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, pati të enjten një bisedë të përzemërt telefonike me kancelarin e Republikës së Austrisë, Sebastian Kurz, të cilit i shprehu mirënjohjen e Qeverisë dhe popullit të Kosovës për përkrahjen e vazhdueshme që Austria i ka dhënë vendit tonë. Gjatë kësaj bisede kryeministri Hoti e njoftoi kancelarin austriak për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, posaçërisht për menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe

rimëkëmbjen ekonomike të vendit si pasojë e kësaj pandemie.

Kryeministri Hoti tha se Qeveria e Kosovës është plotësisht e përkushtuar për ta përmbyllur me sukses procesin e integritetit të vendit në strukturat euroatlantike dhe, si përherë deri më tani, pret mbështetjen e plotë të kancelarit Kurz dhe të vendit të tij. Në këtë kontekst, kryeministri Hoti i propozoi kancelarit Kurz krijimin e Forumit Ekonomik Austri - Kosovë me pjesëmarrjen e të dy kryeministrave.

Sa i përket dialogut me Serbinë,

kryeministri Hoti theksoi se Kosova është e gatshme që dialogu të vazhdojë, me qëllim që ndërmjet të dy vendeve të arrihet një marrëveshje e përhershme paqeje e stabiliteti, që nënkupton edhe njohjen reciproke. Ndërsa kancelari austriak Sebastian Kurz ritheksoi gatishmërinë e vendit të tij për ta mbështetur edhe më tej Kosovën dhe të gjithë rajonin në procesin e integritetit evropian, duke theksuar se Ballkani Perëndimor vazhdon të mbetet ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme austriake.

Shqiptarët përfaqësohen me tre deputetë në Kuvendin e Serbisë

BUJANOC, 2 KORRIK (ER) - Shqiptarët e Luginës së Preshevës zyrtarisht kanë tre përfaqësues të vet në Kuvendin e Serbisë. Ish-kryetari i Bujanocit, Shaip Kamberi, i cili tash e tutje pritet të jetë deputet në Kuvendin e Serbisë, ka bërë me dije se koalicioni i partive shqiptare përfundimisht ka arritur të sigurojë tri mandate në Kuvendin e Serbisë. Kamberi ka thënë se ky sukses i partive shqiptare në Luginë ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit mes partive shqiptare me Tiranën zyrtare dhe

përkrahjes edhe nga Prishtina. Ai ka thënë se kjo ngritje e fuqisë politike të shqiptarëve duhet materializuar në ndërtimin e strategjisë së përbashkët. "Tre mandate për deputetë të siguruara tashmë nga 'ADSh - Lugina e Bashkuar' si rezultat i një bashkëpunimi të partive shqiptare me Tiranën dhe përkrahjes së Prishtinës. Ngritje e fuqisë politike të shqiptarëve që duhet materializuar në ndërtimin e strategjisë së përbashkët", ka shkruar Kamberi në llogarinë e vet në "Facebook".



BE-ja i dhuron Kosovës 6 000 teste për Covid-19

Bashkimi Evropian (BE) i ka dhuruar Kosovës mijëra pajisje mjekësore me qëllim të lehtësimit të luftës kundër koronavirusit të ri. Në kuadër të ndihmës në vlerë të 800 000 eurove përfshihen pajisje si: 6 000 kite për testim të Covid-19, 90 shtretër, mbi 67 000 maska dhe aparaturë tjetër. Përfaqësuesja e BE-së në Kosovë, Natalia Apostolova, ka njoftuar se BE-ja do t'i dorëzojë javën e ardhshme Kosovës edhe disa ventilatorë, në kohën kur Klinika Infektive në Prishtinë veçse është e mbushur me pacientë të sëmurë me Covid-19



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Bashkimi Evropian i ka dhuruar të enjten Kosovës mijëra pajisje mjekësore me qëllim të lehtësimit të luftës kundër koronavirusit të ri. Në kuadër të ndihmës në vlerë të 800 000 eurove përfshihen pajisje si: 6 000 kite për testim të koronavirusit, 90 shtretër, mbi 67 000 maska dhe aparaturë tjetër.

Pjesë e kësaj ngjarjeje ka qenë përfaqësuesja e BE-së në Kosovë, Natalia Apostolova, e cila u ka bërë thirrje banorëve të Kosovës për kujdes të shtuar. "Respektoni kufizimet shumë të

rëndësishme për ta luftuar pandeminë. Për momentin e shohim që gjithandej Prishtinës, gjithandej Kosovës njerëzit po dalin, nuk po respektojnë distancimin fizik, nuk po vendosin maska dhe nuk janë fare të vetëdijshëm për pasojat tepër të rënda që po ndodhin, ndoshta jo për ne, por për më të moshuarit tanë", ka deklaruar ajo.

Apostolova ka njoftuar se BE-ja do t'i dorëzojë javën e ardhshme Kosovës edhe disa ventilatorë në kohën kur Klinika Infektive në Prishtinë veç është e mbushur me pacientë të sëmurë me Covid-19.

Teksa ka falënderuar bllokun

evropian për ndihmën, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, u ka bërë thirrje qytetarëve që të kenë prioritet shëndetin e vet e jo dallimet politike në kohë pandemie. "Mos lejoni që të kemi donacione të tilla në pafundësi. Na mundësoni ta përfundojmë pandeminë. Respektojini masat, zbatoni rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë",

ka thënë ministri Zemaj. Marrë parasysh të dhënat e fundit, autoritetet në Kosovë kanë raportuar për 2 991 persona të infektuar me koronavirusin e ri. Prej tyre, 1 293 persona janë shëruar, derisa 54 pacientë kanë vdekur. Pas rritjes së numrit të rasteve të reja me koronavirus, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur të mërkurën ka miratuar disa masa shtesë për

ta frenuar përhapjen e sëmundjes Covid-19.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka paralajmëruar se nëse masat e reja nuk zbatohen, Qeveria e Kosovës do t'i rikthejë masat rigorozë që rekomandohen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Megjithatë, ministri Zemaj nuk ka dhënë detaje se për çfarë masash rigorozë bëhet fjalë.

Kuvendi dhe qeveria britanike nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi për emërimet profesionale

**EPOKA
ERE** **Qndresa RAMA**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, përfaqësuar nga Ambasada Britanike, kanë nënshkruar të enjten një memorandum mirëkuptimi për të siguruar emërimet profesionale të udhëheqësve të institucioneve dhe organeve publike nëpërmes proceseve të drejta dhe transparente të rekrutimit. Memorandumi i Mirëkuptimit u nënshkrua nga kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovës, Nicholas Abbot.

Kryetarja Osmani tha pas nënshkrimit se ky memorandum është vullnet i dyanshëm në mes të Kuvendit



të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, që ka për synim rritjen e transparencës në përzgjedhjen e personave në pozitë udhëheqëse në borde dhe agjenci të pavarura. "Pozita e paraparat janë në përgjegjësinë e Kuvendit të

Kosovës, ku trupat e tyre udhëheqëse dhe menaxheriale zgjidhen nga Kuvendi dhe disa që inicohen nga qeveria, por që lista finale votohet në Kuvendin e Kosovës", tha Osmani. Sipas saj, profesionistët duhet të

përzgjidhen në bazë të meritokracisë. "Kuvendi vërtet përbëhet nga politikanë, mirëpo politikanët që betimin e tyre, ditën e zgjedhjes, e kanë dhënë duke thënë se do të punojnë në interes të Republikës dhe qytetarëve,

duhet ta dinë se kjo republikë dhe qytetarët që jetojnë në të asnjëherë nuk do ta arrijnë mirëqenien e duhur në qoftë se shkelen parimet e meritokracisë dhe transparencës. Duhet që këtë premtim që e kemi dhënë ta realizojmë", tha kryetarja Osmani.

Ndërkaq ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbot, tha se me këtë mënyrë ka pasur procese të suksesshme rekrutuese. Ai u ka bërë thirrje profesionistëve të aplikojnë dhe të kontribuojnë në udhëheqjen e institucioneve. "Nuk mund të zgjidhen nga jashtë, por vetëm me vullnet politik dhe me punë profesionale. Jam i vetëdijshëm se kjo nuk është ndërmarrje e lehtë, por parakusht për zhvillimin. Projekti ju ofron mbështetje, por emërimet u takojnë institucioneve në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi", ka thënë Abbott.

FLET PËR “EPOKËN E RE”, EMRUSH UJKANI

DEKLARIMET E SHBA-së PËR LIBERALIZIM



Njohësi i integrameve evropiane, Emrush Ujkani, ka shprehur optimizëm se çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën do t'i jepet epilog gjatë presidencës gjermane të Këshillit të BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se ngritja e zërit të ShBA-së për këtë çështje do ta ketë ndikimin e vet. Ujkani ka bërë me dije se liberalizimi i vizave me Republikën e Kosovës është i një rëndësie të veçantë për besueshmërinë e Bashkimit Evropian në raport me Kosovën

Gjermania do të jetë disfatuese nëse nuk do të arrijë ta çojë deri në fund këtë mesazh. Nëse BE-ja dëshiron ta ketë një rol kredibil në procesin e ndërmjetësimit në dialogun Kosovë - Serbia, veprimi më i mirë për ta rifituar këtë besim te pala e Kosovës do të ishte vendimmarrja për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën”, është shprehur Ujkani.

“Epoka e re”: Gjermania tashmë ka marrë Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian. Cila është rëndësia e kësaj presidencie për BE-në dhe Ballkanin Perëndimor?
Ujkani: Në kohë të krizës së

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Njohësi i integrameve evropiane, Emrush Ujkani, beson se ngritja e zërit të ShBA-së ndaj BE-së për mosliberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës do ta ketë rolin e vet. Ai ka shprehur optimizëm se gjatë presidencës gjermane të Këshillit të Bashkimit Evropian do të futet në agjendë çështja e

liberalizimit për Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Ujkani ka deklaruar se kjo presidencë duhet t'i japë epilog këtij procesi. “Në fokus të kësaj presidencie në raport me Kosovën duhet të jetë çështja e liberalizimit të vizave. Pra, BE-ja gjatë kësaj presidencie duhet t'i japë epilog procesit të lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës në Zonën Shengen. Nëse kjo nuk ndodh gjatë kësaj

periudhe kohore, do të jetë vështirë të mendohet se në presidencat e tjera do të ketë një shtytje në këtë proces”, ka thënë Ujkani.

Ai ka treguar se ndikimin në këtë proces do ta ketë edhe fakti se deklarimet e ShBA-së për këtë çështje janë shtuar. “Jo që vendet e BE-së do t'i binden ShBA-së, por deklarimi i zëshëm i ShBA-së, se BE-ja nuk po është në gjendje që ta përfundojë një obligim shumë

të vogël ndaj Kosovës e lëre më se do ta zgjidhë problemin në mes të Kosovës dhe Serbisë, do ta ketë ndikimin e vet”, ka deklaruar ai.

Ujkani ka vlerësuar se vendimmarrja e BE-së gjatë kësaj presidencie për procesin e liberalizimit të vizave do ta rriste kredibilitetin e BE-së në raport me Kosovën. “Ngritjen e zërit të ShBA-së për këtë çështje, mendoj se BE-ja do ta marrë më seriozisht dhe

ICITAP, partner i MD-së për ngritjen e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të enjten në takim Steve Hewitt, këshilltar i lartë i Inteligjencës nga Programi i ndihmës ndërkombëtare për trajnime në hetimet penale (ICITAP) si dhe Koordinatorën e Programit të Inteligjencës, Linda Gashi. Gjatë këtij takimi, ministri Selimi u shpreh falënderues ndaj ICITAP për partneritetin e ofruar ndaj Ministrisë së Drejtësisë,

veçanërisht për donacionet dhe mbështetjen në baza ditore me qëllim të ndërtimit të kapacitetit intelektual dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ministri Selimi theksoi se mbeten të angazhuar për përmirësimin e legjislacionit për luftimin e dukurive negative, krimin të organizuar dhe korrupsionit dhe sipas tij, ndihma dhe asistencë për ngritjen e kapaciteteve

vendore dhe profesionalizmit vlerësohet si shumë e nevojshme dhe për këtë përkrahja nga ekspertët e ICITAP është shumë e dobishme.

Nga ana tjetër, Hewitt ka falënderuar ministrin Selimi dhe ka shprehur gatishmërinë e plotë për të vijuar me mbështetjen e ICITAP-it për angazhim të mëtutjeshme në ngritjen e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit.



TË VIZAVE DO TË NDIKOJNË TE BE-ja



Kosovën duhet të jetë çështja e liberalizimit të vizave. Pra, BE-ja gjatë kësaj presidencë duhet t'i japë epilog procesit të lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës në Zonën Shengen. Nëse kjo nuk ndodh gjatë kësaj periudhe kohore, do të jetë vështirë të mendohet se në presidencat e tjera do të ketë shtytje të këtij procesi. Domethënë, pritjet nga presidencat e ardhshme do të jenë më të zbehta.

“Epoka e re”: Pse duhet të jemi më optimistë se në këtë presidencë do të ndodhë vendimmarrja për liberalizim të vizave?

Ujkani: Mendoj se optimizmin e shton fakti se deklarimet e ShBA-së për këtë çështje janë shtuar. Jo që vendet e BE-së do t'i binden ShBA-së, por deklarimi i zëshëm i ShBA-së se BE-ja nuk po është në gjendje që ta përfundojë një obligim shumë të vogël ndaj Kosovës e lëre më se do ta zgjidhë problemin në mes të Kosovës dhe Serbisë, do ta ketë ndikimin e vet. Ngritjen e zërit të ShBA-së për këtë çështje, mendoj se BE-ja do ta marrë më seriozisht dhe Gjermania do të jetë disfatuese nëse nuk do të arrijë ta çoj deri në fund këtë mesazh. Nëse BE-ja dëshiron ta ketë një rol kredibil në procesin e ndërmjetësimit në dialogun Kosovë - Serbia, veprimi më i mirë për ta rifituar këtë besim te pala e Kosovës do të ishte vendimmarrja për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën.

“Epoka e re”: Çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës gjatë kësaj kohe që t'i bindin vendet anëtare të BE-së për këtë proces?

Ujkani: Së pari Kosova duhet të ketë stabilitet politik. E dimë që kohët e fundit e kemi një periudhë që nuk kemi pasur ndonjë stabilitet të qëndrueshëm. Dhe, së dyti, institucionet tona duhet t'i zbatojnë të gjitha obligimet që i kemi marrë në kuadër të udhëzuesit për liberalizim të vizave. Pra, të punohet për zbatim të forcimit të rendit dhe ligjit.

“Epoka e re”: Në rrethanat më të mira, kur do të mund të prisnim futjen në agjendë të kësaj çështje?

Ujkani: Agjenda e vendeve anëtare është agjendë politike. Nëse dinamika e zhvillimeve e kërkon një gjë të tillë, kjo

çështje shumë lehtë mund të futet në agjendë nga vendet anëtare, në këtë rast nga Gjermania. Kështu që, në rrethanat më ideale, nëse do të bindeshin vendet anëtare, mendoj se kjo do të ndodhë në fillim të muajit dhjetor.

“Epoka e re”: Kosova është në prag të rifillimit të dialogut me Serbinë. Sa është rreziku që kjo çështje të ndërlihet me procesin e dialogut Kosovë - Serbi?

Ujkani: Nuk besoj se këto dy

proceset do të ndërlihen mes vete.


“Epoka e re”: Disa ditë më parë një grup eurodeputetësh i kanë dërguar një letër kancelares gjermane Angela Merkel, nga e cila kanë kërkuar që të vendoset në agjendën e presidencës gjermane të Këshillit Evropian çështja e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Çfarë ndikimi mund të ketë kjo?

Ujkani: Ky është një bashkëpunim në mes të deputetëve të Parlamentit

Evropian dhe zyrtarëve të shteteve anëtare. Natyrisht se kjo ka peshën e vet, mirëpo nuk duhet të harrojmë se parlamenti evropian edhe më herët ka pasur vullnetin e njëjtë që të ketë një lëvizje në këtë drejtim. Mendoj se kjo letër ka ndodhur në momentin e duhur, por nuk është diçka vendimmarrëse. Pra, nuk do të luajë ndonjë rol kyç në këtë proces. Dinamika e zhvillimeve do të jetë ajo që do ta përcaktojë çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Rasti Mehmetaj, ministri Selimi i dërgon letër Apostolovës

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, përmes një letre i ka bërë thirrje shëfës së Zyrës së BE-së në Kosovë - përfaqësueses së posaçme të BE-së, Nataliya Apostolova, që ta përdorë fuqinë diplomatike për t'i bindur autoritetet e Serbisë që ta përdorin Marrëveshjen për Ndhimë Juridike që është nënshkruar ndërmjet vendeve tona me mbështetjen e BE-së, rreth rastit të Nezir Mehmetaj që mbahet në Serbi nën akuza të rreme e të motivuara politikisht. “E nderuara Ambasadore Apostolova, po ju drejtohem me këtë letër si një notë proteste mbi zhvillimet shqetësuese dhe veprimet e Serbisë në arrestimin e qytetarëve të Kosovës nën akuza të rreme dhe të motivuara politikisht. Unë bëj thirrje që Zyra e BE-së në Kosovë t'i ndërmarë veprimet e nevojshme për t'i ndërprerë mundimet e vazhdueshme të Serbisë ndaj qytetarëve tanë me procedura të tilla të kundërligjshme që ua mohojnë atyre të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Rasti më i fundit është ai i Nezir Mehmetajt, i cili është arrestuar dhe ndaluar në mënyrë të kundërligjshme që nga 3 janari nën akuzat e anëtarë-



sisë së tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe akuza për vrasje, që supozohet se kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë. Ndonëse rasti i z. Mehmetaj assesi nuk është i pari, është një rast shumë shqetësues duke pasur parasysh mbajtjen e tij të

vazhdueshme edhe pas kërkesave të shumta nga institucionet tona dhe zyra jonë ndërlidhëse në Beograd”, ka thënë Selimi. Ai ka thënë se Mehmetaj po mbahet në mënyrë të kundërligjshme nga një vend që nuk mund t'ia garantojë atij të drejtën e tij për një gjykim të drejtë. “Ky rast, si shumë të tjerë para tij, dëshmon se Serbia ndjekë një drejtësi selektive përmes së cilës i maltreton qytetarët tanë me akuza të pavlefshme, ndërsa pengon ndjekjen dhe dënimin e qytetarëve të vet me akuza të njëllota”, ka thënë ministri Selimi, duke kërkuar që Apostolova ta ushtrojë fuqinë diplomatike për të mos lejuar këtë ndjekje të drejtësisë selektive nga Serbia.



INTERVISTË ME VEPRIMTARIN E ÇËSHJES KOMBËTARE DHE ISH-USHTARIN E UÇK-SË, ISAK TUSHA

Gara në zgjedhjet e Maqedonisë zhvillohet mes katër koncepteve politike

Veprimtari i çështjes kombëtare, ish-ushtar i UÇK-se, Isak Tusha, ka folur për zhvillimet e fundit politike në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht për fushatën zgjedhore në këto shtet. Ai ka thënë se gara në këto zgjedhje do të zhvillohet mes katër koncepteve politike. Tusha ka pohuar se Maqedonisë i duhet një frymë e re në qeverisje. Dhe, sipas tij, kjo frymë tashmë duket se po vjen në këto zgjedhje



“Epoka e re”: A do ta mbështesin partitë shqiptare edhe në këto zgjedhje Zaevin për kryeministër? Nëse po, cila është arsyeja për një veprim të tillë?

Isak Tusha: Është irelevante nëse në kampin maqedonas fiton Zaevi apo Mickovski që është kreu i VMRO DPMNE-së. Si njëri e si tjetri, nëse partneri i tyre i koalicionit do të ishte serioz, do të kishin një qasje më serioze ndaj shqiptarëve. Kam bindje të thellë se kësaj radhe situata do të jetë më ndryshe. Për shkak se BDI tashmë ka gjasa të kalojë në opozitë, qoftë Zaevi apo Mickovski, do të duhet të përgatiten mirë sepse përballë do të ketë një qasje të re politike, që lirisht mund të them se është e panjohur për ta. Në gjithë këtë, e kam patjetër ta përmend një detaj që mund të them se është përshtypja ime personale, ndërkombëtarët duket se edhe më tej preferencat për në kampin maqedonas i kanë të drejtuar kah Zaevi, por votat e 15 korrikut do të na tregojnë më saktë se cili nga ata dy do të korrë fitore, por që në thelb nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë për shqiptarët.

“Epoka e re”: Rinia ka ikur shpejt nga Maqedonia e Veriut. Por, pak ritmin e ka ngadalësuar pandemia. atëHerë, a mendoni se prapë do të vazhdojë e njëjta gjendje pas pandemisë? Dhe, si do të jetë rezultati më 15 korrik pasi që rinia ka ikur?

Isak Tusha: Po, ka ndodhur një eksod masiv i shqiptarëve në vazhdimësi. Nëse lëvizni nëpër vendbanimet shqiptare do të shihni shumë rrugë të zbrazëta pa rini shumë banka shkollore pa nxënës. Më vjen keq që duhet ta them, por atë që nuk e ka bërë Rankoviqi, për fat të keq, është bërë në këto vitet e fundit. Ka ndodhur një eksod masiv. Sot shqiptari i Maqedonisë së Veriut ka ngelur pa shpresë dhe kjo do të thotë se thellë në shpirt ai ka ngelur pa vullnet. Dhe kjo është

elefantit dhe miut kur kanë ecur mbi urë... Kur fillon të dridhet ura miu i thotë elefantit “Çdoherë kur ne kalojmë këndeje pari, dridhet ura”. Edhe puna e Besës me LSDM-në është diçka e këtillë. Ai subjekt, nuk po dua të tingëlloj keq, nuk ka kapacitet të matet me një parti siç është LSDM. Dhe, mos të harrojmë se motoja e kësaj partie maqedonase është mozheme. Për ata që nuk e kuptojnë, kjo përkthehet “mundemi”. Ndryshe është të garosh nën siglën shqiptare, ndryshe nën siglën maqedonase.

“Epoka e re”: A ia vlen kandidati shqiptar për kryeministër?

Isak Tusha: Po gjithsesi, shqiptarët edhe nga historia kanë dëshmuar se dinë të jenë në krye të institucioneve të larta dhe në krye të shumë proceseve, por ajo çka i dallon kandidatët shqiptarë nga kandidatët e tjerë është se pushtetin e shohin si mjet dhe jo si qëllim.

“Epoka e re”: Kujt po i shërbejnë shqiptarët?

Isak Tusha: Po deri më tani dihet qartë se kujt i kanë shërbyer, por është mirë të dalin nga ëndrrat dhe t'i rreken punës. Ne kemi nevojë të merremi me projekte konkrete dhe të fillojmë të jetojmë me dinjitet dhe paralelisht t'i ndjekim dhe zhvillojmë hapat tanë gjeopolitikë, në përputhje me interesat tona kombëtare. Zhvillimi i një kombi nuk i takon vetëm një brezi, por të gjithë brezave. Kalaja nuk ndërtohet vetëm me një tullë. Ne të gjithë kemi nevojë ta japim kontributin tonë, në përputhje me realitetin kohor në të cilin gjendemi.

“Epoka e re”: Në këto zgjedhje, a mendoni se do të ketë ndryshim në raport me zgjedhjet e kaluara?

Isak Tusha: Nga të thënat më lart dhe analizimi i rrethanave, kam bindjen se shqiptarët e Maqedonisë së Veriut më 16 korrik do të zgjohen me një hartë të re politike, e cila mund ta dërgojë BDI-në në opozitë. Gjithashtu, edhe partitë politike në Shqipëri e Kosovë do të ishte mirë që në këto zgjedhje parlamentare në Maqedoninë e Veriut mos të anojnë apo ndërhyjnë, por të qëndrojnë jashtë ndikimeve të mundëshme apo favorizimeve të ndonjë subjekti të caktuar politik pasi që nuk kanë kontribuar në unifikimin e bashkimit të subjekteve politike. Iu kisha sugjeruar që t'i vëzhgoni dhe për në të ardhmen do ta kishit më të lehtë se ku dhe për kë do të përcaktoheni. Por, ajo që është më me rëndësi për mua, është shëndeti i qytetarëve në këtë kohë të pandemisë dhe natyrisht zbatimi i parimeve demokratike në ditën e zgjedhjeve.

EPOKA E RE **Ismail REXHEPI**

PRISHTINË, 2 KORRIK -

“Epoka e re”: Në këto zgjedhje parlamentare, a shihni unifikim të partive shqiptare në Maqedoninë e Veriut?

Isak Tusha: Çështja e unifikimit të votës shqiptare, me moton “bashkimi bën fuqi”, më duket se na ka ngelur vetëm në fjalorin politik. Gjithsesi se në rrethana të ndryshme këtë Çështje duhet parë ndryshe në kontekst të kohës dhe hapësirës. Për shembull, nëse flasim për shqiptarët e Luginës së Preshevës, atje bashkimi i forcave politike ishte i domosdoshëm dhe, si i tillë, është mirë që ndodhi dhe nuk u shfaqën bajraktarizma, siç ka qenë tashmë tri dekada më radhë. Por, kur është fjala për Maqedoninë e Veriut, situata është pak më ndryshe. Bëhet fjalë për dy kampe të fuqishëm të ndarë në vija etnike: maqedonase dhe shqiptare. Ndërsa kjo ndarje është krejt normale të jetë evidente edhe brenda kampit. Në bllokun maqedonas kemi të djathtë dhe të majtë. E njëjta situatë pak a shumë edhe në kampin politik shqiptar. Në këtë drejtim më duhet thënë se të djathtët janë Alternativa dhe Aleanca që shkojnë bashkërisht në zgjedhje. Dhe, BDI, e cila në bazë të ngjyrave partiake dhe asaj që e ka shfaqur si koncept prej fillimit, është parti e majtë. Andaj, gara kësaj radhe zhvillohet mes katër koncepteve politike.

“Epoka e re”: Në këto zgjedhje a do të ketë ndryshim te partitë politike shqiptare në krahasim me zgjedhjet e kaluara?

Isak Tusha: Ka shpresë se ndryshimi do të vijë. Shqiptari i Maqedonisë së Veriut tashmë në mënyrë të hapur po tregon se nuk e duron folklorin patetik që shitet në emër të patriotizmit. Ai, krahas dëshirave kombëtare, ka edhe nevoja socio-ekonomike. Prandaj, mund të them lirisht se në këto zgjedhje, në kampin politik shqiptar do të ngadhënjejë koncepti konkret i cili ofron punë, ofron paga më të mira, asistencë sociale, barazi para ligjit, e jo dikush që thirret në ide të paanalizuara mirë e që në thelb politikisht për momentin janë utopike, siç është ajo për kryeministër shqiptar. Pra, për ta

pasur lexuesi më të qartë, edhe në Maqedoni të Veriut, kryeministrin e fiton ai i cili i fiton votat. E votat, për fat të keq, edhe më tej në këtë vend numerikisht i kanë më të lartë, partitë e bllokut maqedonas.

“Epoka e re”: A ka pasur përpjekje nga liderët shqiptarë që t'i ulin në një tavolinë krerët e partive politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut për t'u bërë bashkë ato?

Isak Tusha: Të paktën unë nuk jam në rrjedha për një nismë të tillë. Dhe, siç e thashë në fillim, është mirë që nuk ka pasur një iniciativë të tillë sepse do të ishte përpjekje për ta penguar garën e duhur politike dhe të ideve. Shqiptarët nuk kanë nevojë të kthehen në epokën e komunizmit që ta kenë vetëm një mendim politik, disa alternativa politike veç sa e rrisin konkurrencën dhe ofertën cilësore për votuesin. Siç edhe e shpjegova më lart, shqiptarët që jetojnë në Maqedoni të Veriut jetojnë jashtë kontekstit politik të shqiptarëve që, për fat të keq, ende jetojnë nën Serbi. Në Maqedoni të Veriut nuk kemi pakicë që të mbrohemi nga majorizimi. Ne deri më tani kemi vuajtur për shkak të mospërfaqësimit të duhur institucional në ekzekutiv. Mos të harrojmë se Çdoherë thaujse një e treta e Qeverisë së Shkupit është drejtuar nga shqiptarët e të cilët, për fat të keq, më shumë u kanë shërbyer interesave klanore sesa kombit. Pra, neve na duhet një frymë e re në qeverisje. Dhe kjo frymë tashmë duket se po vjen në këto zgjedhje.

“Epoka e re”: Sipas jush, Çka duhet të bëjnë subjektet politike që të e kthejnë një realitet të ri në këto zgjedhje?

Isak Tusha: Me një program të mirëmenduar dhe vullnetit të mirë do të ishte i mundur realizimi në praktikë, gjendja e shqiptarëve, pse jo edhe e gjithë qytetarëve shumë shpejt mund të ndryshojë rrënjësisht. Nëse hiqen zhvajtja dhe korrupsioni nga terreni politik, e mira e përgjithshme bëhet realitet për Çdo pore të shoqërisë. Shqiptarët e kanë shansin historik t'i heqin nga skena ata që kanë keqpërdorur motivet dhe vullnetin kombëtar e patriotik për interesa meskine.

Ndërron jetë babi i heroit Afrim Zhitia, Osman Zhitia

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Ka ndërruar jetë të enjten Osman Zhitia, babai i heroit të kombit Afrim Zhitia. Baca Osman ishte shembulli i burrit shqiptar që tërë jetën ia kushtoi lirisë së vendit. Ndaj këtij lajmi pikëllues kanë reaguar përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe partiake.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shprehur i pikëlluar me vdekjen e bacës Osman. Ai ka thënë se Osman Zhitia ishte frymëzues i një familjeje atdhetare të përkushtuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Më pikëlloi pa masë vdekja e Osman Zhitisë, babait të Heroit të Kosovës, Afrim Zhitia. Osman Zhitia ishte frymëzues i një familjeje atdhetare të përkushtuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ai ishte një burrë i fortë, solidar dhe shumë i respektuar prej të gjithëve. Ngushëllime të sinqerta familjes Zhitia dhe gjithë të afërmeve të



tyre", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, e ka quajtur lajm të dhimbshëm vdekjen e Osman Zhitisë. Ai ka thënë se baca Osman ishte atdhetar i madh

dhe burim frymëzimi në rrugëtimin tonë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Lajm i dhimbshëm vdekja e Osman Zhitisë. Babai i heroit Afrim Zhitia, baca Osman, ishte atdhetar i madh dhe burim frymëzimi në rrugëtimin tonë

për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Jeta e tij ishte mes përkushtimit, qëndresës e krenarisë. Do të na mungojë të gjithëve. Ngushëllime familjes dhe gjithë kombit!", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Në anën tjetër, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se me pikëllim e ka marrë lajm për vdekjen e Osman Zhitisë. Ai ka thënë se baca Osman ishte shembulli i burrit shqiptar, i cili tërë jetë ia ka kushtuar lirisë së Kosovës. "Shembulli i burrit shqiptar që tërë jetën ia kushtoi lirisë së vendit, me të gjitha forcat, deri në frymën e fundit. Sapo mora lajm pikëllues për ndarjen e tij nga jeta. Dhembjen po e ndajmë së bashku me familjen Zhitia dhe të gjithë ata që e kanë njohur. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në


"Facebook".

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, e ka quajtur pikëllues lajm për vdekjen e Osman Zhitisë, babait të heroit të kombit, Afrim Zhitia. Me këtë rast, Limaj në emër të dhe të Nismës Socialdemokrate i ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjes Zhitia, miqve dhe të gjithë atyre që e kanë njohur bacën Osman. "Baca Osman do të mbetet përherë në kujtesën tonë si një atdhetar i shquar që nuk kurseu asgjë nga vetja për lirinë e Kosovës. I përjetshëm qoftë kujtimi për bacën Osman!", ka thënë Limaj. Baca Osman Zhitia është ndarë nga jeta dy muaj pas vdekjes së djalit të tij, Sylë Zhitia. Kurse 31 vjet më parë, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu kishin rënë heroikisht pas një luftimi me makinerinë policore të ish-Jugosllavisë, përkatësisht më 2 nëntor 1989 në "Bregun e Diellit" në Prishtinë.

NDEROHEN ME MIRËNJOHJE DELEGATËT E DEKLARATËS SË 2 KORRIKUT

Delegatët e 2 Korrikut kërkojnë përkujdesje institucionale

Me rastin e Deklaratës së 2 Korrikut, Iljaz Ramajli, ish-kryetar i Kuvendit të atëhershëm të Kosovës, ka kërkuar angazhimin e Qeverisë së Kosovës që kujdesi për delegatët e asaj kohe të ngrihet nga niveli i vullnetit politik në obligim institucional dhe ligjor. Në këtë datë, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka nderuar me mirënjohje delegatët e Deklaratës së 2 Korrikut të vitit 1990



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka ndarë mirënjohje për përfaqësuesit e legjislativës e cila, para dyerve të tempullit të lirisë, e ka artikuluar qartë pikësynimin e pathyeshëm për liri në Deklaratën e 2 Korrikut të vitit 1990. Sipas Osmanit, deklarata e miratuar nga 114 delegatët e asaj kohe ishte akti politik dhe juridik me të cilin Kosova përfundimisht nuk pranoi t'i nënshtrohej hegjemonisë dhe i hapi udhë artikulimit të shtetësisë së Kosovës, e cila u konkretizua me Kushtetutën e Kaçanikut të 7 shtatorit të po atij viti. "Ua shpreha mirënjohjen më të thellë timen dhe të Kuvendit të Kosovës për aktin sa heroik, aq njerëzor të secilit prej tyre, duke nisur nga ish-kryetari Ramajli,

delegatët e pranishëm sot, delegatët që për arsye moshe e shëndeti nuk mund të ishin sot me ne, në veçanti atyre grave e burrave që tashmë nuk janë mes nesh. Që të gjithë do të mbahen në mend përjetësisht, sepse në vorbullën politike të kohës, kur vendi ynë po vihej egërsisht nën çizmen e regjimit serb, ata i dolën zot atij dhe e artikuluan vullnetin politik të qytetarëve liridashës për Kosovën Republikë", ka thënë ajo. Osmani ka theksuar se themelet e shtetit të Kosovës qëndrojnë edhe mbi Deklaratën e 2 Korrikut të vitit 1990. "Sot themelet e shtetit tonë qëndrojnë mbi vendimin e këtyre delegatëve për ta refuzuar dhunën dhe për t'i përqaftuar vlerat e lirisë. Prandaj, si kryetare e Kuvendit i falënderoj në emër të të gjitha legjislativave pas asaj të 2 korrikut dhe i siguroj se çdo veprim ynë për jetësimin e lirive njerëzore dhe për

promovimin e tyre do të jetë i frymëzuar nga parimet që i vulosën këta delegatë me Deklaratën Kushtetuese", ka thënë Osmani. Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut e ka kujtuar edhe presidenti Hashim Thaçi. Ai ka thënë se Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990 është moment i paharrueshëm politik dhe historik që na bashkoi në rrugën e pavarësisë. "Si akt politiko-juridik ishte shprehje e vullnetit dhe aspiratave të popullit tonë për liri, demokraci dhe pavarësi, të cilat i institucionalizua pas një procesi të gjatë me shumë sakrifica. Mirënjohje të gjithë atyre që pandalshëm punuan për ta bërë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran", ka thënë Thaçi. Ndërkaq kryeministri Avdullah Hoti ka pritur në takim një grup delegatësh, të cilët më 2 korrik 1990, në rrethana të

jashtëzakonshme, miratuan Deklaratën Kushtetuese e cila shënoi hapin e parë institucional në procesin e gjatë për pavarësinë e Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Hoti tha se kjo deklarata që moment kthese në historinë më të re të Kosovës, sepse ishte akti i parë i artikulimit të qartë të vizionit dhe të vullnetit politik të qytetarëve dhe të institucioneve të Kosovës për liri, demokraci dhe pavarësi. "Deklarata e 2 Korrikut e vitit 1990 do të kujtohet gjithmonë si akt që sublimon përpjekjet e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Bashkë me aktet e tjera që e pasuan atë, si Kushtetuta e Kaçanikut dhe Referendumi për pavarësi, kjo deklarata shënon kthesën historike në përpjekjet tona të gjithanshme për liri në dekadën e fundit të shekullit XX", tha kryeministri Hoti. Në këtë ditë të rëndësishme, vijoi kryeministri Hoti, si qeveri e

vendit u shprehin mirënjohjen të gjithë delegatëve të Kuvendit të 2 Korrikut, të cilët, në koordinim me lëvizjen politike demokratike të asaj kohe, me vendimet e tyre të guximshme ia hapën Kosovës rrugën e pakthyeshme të mëvetësisë dhe të integriteteve euroatlantike. Ndërsa në emër të delegatëve, të cilët shpallën Deklaratën e 2 Korrikut dhe miratuan Kushtetutën e 7 Shtatorit, ka folur Iljaz Ramajli, ish-kryetar i Kuvendit të atëhershëm të Kosovës, i cili e ka falënderuar kryeministrin Hoti për pritjen, si dhe për angazhimin e Qeverisë së Kosovës që kujdesi për delegatët e asaj kohe të ngrihet nga niveli i vullnetit politik, në obligim institucional dhe ligjor. Deklaratën e 2 Korrikut e kanë kujtuar edhe liderët partiakë, të cilët kanë vlerësuar se 2 korriku do të mbetet përgjithmonë në kujtesën historike të shqiptarëve.

Sindikata e sektorit privat shpreh shqetësim për mospagesën e punëtorëve nga qeveria

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat e Kosovës ka reaguar lidhur me mospagesën e pagave nga Pakoja Emergjente Covid-19 për punëtorët. Përmes një komunikate për media kjo sindikatë vlerëson se punëtorët e sektorit privat po vazhdojnë të diskriminohen dhe për këtë përgjegjës e bën politikën. “Punëtorët e këtij sektori diskriminohen në kushte normale, por edhe në kushte emergjente. Kush është përgjegjës dhe kush dha përgjegjësi për skandalin e keqpërdorimit dhe mospagesës

së Pakos Emergjente, punëtorët e sektorit privat u diskriminuan vetëm ata. Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë komodë sepse ata nuk qajnë kokën pse këta punëtorë çdo ditë presin në bankat e tyre mos po dalin mjetet e premtuara nga qeveria. Këta bëjnë shaka me shpresat e punëtorëve e nuk ulen që ta miratojnë rishikimin e buxhetit që qeveria t'i kryejë obligimet e veta”, theksohet në këtë komunikatë.

Kjo sindikatë ka mirëpritur iniciativën e Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e kursimeve nga kursimet

pensionale. “Sindikata e mirëpret iniciativën e Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e 10 për qind të Trustit Pensional nga punëtorët, por çka të tërheqim në ku pronarët e kompanive në 50 për qind të rasteve nuk ua kanë paguar fare kontributet punëtorëve në trust, edhe ata që kanë paguar e kanë bërë në një masë simbolike. Nuk thonë rastësisht i varfëri gjithë duhet të jetë i varfër, duke iu ‘falënderuar’ institucioneve tona”, thuhet në komunikatën e Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës.



GPLS-ja: Kosova duhet ta ketë një plan të gjelbër për rimëkëmbjen ekonomike



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka rekomanduar që plani i rimëkëmbjes ekonomike të mos fokusohet vetëm në ekonomi, por i njëjti të jetë më gjithëpërfshirës dhe ta mbrojë mjedisin njëkohësisht, duke marrë parasysh gjendjen alarmante

të ndotjes para shpërthimit të krizës. Sipas GLPS-së, do të ishte shumë vizionare nëse ekonomia dhe mjedisi do të vihehin krahas në procesin e ripërtëritjes post Covid-19 për Kosovën. “Në vazhden e përbaljes me pandeminë pas Pakos Emergjente Fiskale, pako e rimëkëmbjes, me objektiva e kriteret të qarta të mbështetura në zhvillim të qëndrueshëm është

thelbësore. Kjo pako e ardhshme nuk duhet t'i anashkalojë trendët në BE, e cila, duke ruajtur ekonominë, do të duhet të promovojë një rimëkëmbje të sektorëve ekonomikë të cilët janë të kujdesshëm e punojnë në mbrojtjen e mjedisit. Mekanizmat të cilët do të përdoren duke u nisur nga buxheti i Kosovës, fondet apo edhe instrumente të tjera

duhet të shfrytëzohen me kujdes për të ruajtur këtë start të mbarë në drejtim të një mjedisi më të shëndetshëm. Prandaj GLPS vlerëson që së pari Kosova duhet të sigurohet që programet e rimëkëmbjes ekonomike t'u japin përparësi edhe investimeve që mbështesin energjinë e ripërtëritshme, lehtësime ekonomike për prodhuesit të cilët reduktojnë emisionet e

gazrave serrë ose ndihmë për konsolidimin e bizneseve, veçanërisht në sektorët me intensitet të ulët karboni, duke ulur drastikisht emetimet”, thuhet në njoftimin e GPLS-së. Si përfundim GLPS konsideron se Kosova duhet të orientohet medoemos drejt një plani të gjelbër të rimëkëmbjes ekonomike duke u nisur nga rreziku që i kanoset mjedisit përfshirë këtu dhe ajrit.

Përrurohen zyrat shtesë të BQK-së

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë përruruar zyrat shtesë të BQK-së. Guvernatori Mehmeti ka thënë se përrurimi i këtyre zyrave po bëhet në 30-vjetorin e deklaratës së 2 Korrikut që ishte edhe pikënisje për përrjekjet për pavarësinë dhe forcimin e shtetit të Kosovës. "Sektori financiar vazhdimisht është në rritje, prandaj kjo detyrimisht na imponon nevojën që t'i rritim kapacitetet e Bankës Qendrore. Nga sot këto zyra janë funksionale dhe mundësojnë që stafi i BQK-së të ketë kushte më të mira të punës dhe krejt kjo falë mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe përkrahjes së kryetarit të Komunës së Prishtinës. Gjithashtu, shfrytëzoj rastin ta falënderoj edhe Kuvendin Komunal që ka përkrahur iniciativën e

kryetarit", ka thënë guvernatori Mehmeti. Nga ana tjetër, kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka shprehur kënaqësinë për këtë projekt, ku përrmes investimeve i është rritur vlera objektit. "Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është një prej institucioneve më të rëndësishme për neve dhe ka qenë diskutim gati trevjeçar me kërkesën që së pari të ndërtohet një kat në Bankën Qendrore, për çka edhe kemi formuar një komision me Fakultetin e Arkitekturës dhe me ekspertë që kanë rekomanduar që të mos bëhet edhe një kat për shkak se do t'ia ndryshonte pamjen njërit prej objekteve që është më së shumti i paraqitur nëpër fotografitë e Prishtinës. Atëherë ne kemi shkuar me zgjidhjen tjetër që është pronë e Komunës së Prishtinës, ku ka qenë e vendosur për vite të tëra Drejtoria e Infrastrukturës dhe



kemi vendosur që objekti që ka qenë me shumë probleme t'ia ofrojmë Bankës Qendrore, e cila edhe ia ka rritur vlerën objektit të komunës së Prishtinës sepse

kjo ndërtesë nuk mbetet më vetëm një kthinë e errët me plot probleme, po mbetet reprezentative sikur që është edhe BQK-ja", ka thënë Ahmeti.

Numri i stafit që do të vendoset në këto zyra do të jetë 60, ndërsa vlera e investimeve të bëra arrin në shumën e mbi 500 mijë eurove.

BQK-ja dhe odat ekonomike koordinojnë propozimet për rimëkëmbjen ekonomike



PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Në kuadër të takimeve të rregullta me qëllim të koordinimit të propozimeve të përbashkëta për rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë Covid-19, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi dhe drejtorin ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka. Guvernatori Fehmi Mehmeti ka prezantuar propozimet e BQK-së për institucionet qeveritare, duke theksuar nevojën e mbështetjes më të madhe për industrinë e prodhimit në vend. Në të njëjtën kohë guvernatori Mehmeti, ka sqaruar edhe

dispozitat e Udhëzuesit për ristrukturimin e kredive për shkak të Covid-19, duke shprehur besimin se bankat komerciale do t'u dalin në ndihmë ndërmarrjeve të prekura. Ndërsa, drejtuesit e odave ekonomike kanë elaboruar propozimet e të dyja odave përkatëse të cilat përfshijnë rekomandime për përkrahjen financiare, por edhe për lehtësira fiskale për bizneset. Propozimet e përbashkëta të Bankës Qendrore të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë përfshijnë edhe pikat e intervenimit legjislativ të cilat do të mundësojnë zbatimin e masave të propozuara.

Lëshohen në qarkullim pullat postare '30-vjetori i Deklaratës Kushtetuese'

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Me rastin e shënimit të 30-vjetorit të Deklaratës Kushtetuese, Filatelia e Kosovës nga dita e enjte ka emetuar emisionin e ri të pullës postare të titulluar "30-vjetori i Deklaratës Kushtetuese". "Përrmes kësaj pulle postare nderojmë guximin e delegatëve të Kuvendit të Kosovës të cilët, në kushte jashtëzakonisht të vështira okupimi, më 2 korrik të vitit 1990, miratuan publikisht

Deklaratën Kushtetuese, me të cilën Kosova u shpall njësi e veçantë në kuadër të ish-federatës jugosllave. Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990 shënon pikënisjen e shtetësisë së Kosovës, pas dy muajve, më 7 shtator të vitit 1990, të njëjtët delegatë nxorën aktin më të lartë juridik - Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë ata edhe formalisht Kosovën e shpallën Republikë. Pas këtij akti, populli ynë

vazhdoi përrjekjet për liri dhe pavarësi përrmes politikës paqësore, ndërsa çlirimi i Kosovës u arrit më 12 qershor 1999 falë sakrificës së popullit me luftë çlirimtare të udhëhequr nga UÇK-ja dhe të mbështetur nga NATO-ja. Nga 17 shkurti 2008 kemi shtetin e pavarur dhe sovran të Republikës së Kosovës të njohur ndërkombëtarisht nga më se 116 shtete", ka njoftuar Posta e Kosovës.



Haziri: Imamët e Gjilanit kanë dëshmuar vendosmërinë e tyre në luftimin e Covid-19

GJILAN, 2 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka takuar Këshillin e Bashkësisë Islame dhe imamët e xhamive të Gjilanit, me ç'rast janë koordinuar për vazhdimin e përdorimit të masave mbrojtëse për parandalim të pandemisë Covid-19 dhe angazhim të përbashkët deri në normalizim e plotë të gjendjes.

Haziri ka falënderuar Bashkësinë Islame në Gjilan për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë në komitetin për menaxhimin e emergjencave si dhe angazhimin e madh të të gjithë imamëve për bartjen e mesazhit për kujdes dhe respektim të vendimeve për

parandalim të pandemisë në institucionet fetare. "Angazhimi i përbashkët për përbashkët për parandalim të pandemisë ka qenë më i lehtë në kontributin që ka dhënë Këshilli i Bashkësisë Islame dhe imamët e xhamive, e sidomos gjatë rriteve fetare në xhami. Përdorimi i masave mbrojtëse është domosdoshmëri për shëndetin publik dhe ky mesazh është bartur çdo ditë. Është fat i madh që xhamitë nuk kanë qenë burim i infeksionit dhe duhet edhe më tutje ta kemi kujdesin maksimal dhe të apelojmë te qytetarët për përmbajtje të rregullave dhe rekomandimeve që i jep



Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës derisa të shërohet edhe rasti i fundit", ka

thënë Haziri, duke shtuar se bashkëpunimi edhe me komunitetet e tjera fetare është në

nivelin e lartë.

Ndërsa kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu, ka falënderuar kryetarin Haziri për angazhimin maksimal që ka dhënë komuna për përbashkët të pandemisë dhe menaxhimin e vështirë të gjendjes, duke u zotuar se parandalimi është detyrë e të gjithëve, pavarësisht në cilën përgjegjësi dhe detyrë ndodhet. Aliu ka konfirmuar angazhimin e mëtutjeshëm të të gjithë imamëve për respektimin e vendimeve dhe rekomandimeve të institucioneve të shtetit për të mirën e përgjithshme dhe ruajtjen e shëndetit publik.

Pas dy dekadave fshati Greme do të bëhet me rrjet të ujësjellësit



FERIZAJ, 2 KORRIK (ER) - Në fshatin Greme ka filluar të realizohet projekti i ujësjellësit, projekt ky i munguar me vite të tëra në këtë fshat. Nga afër punimet e këtij projekti i ka përcjellë edhe kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar nga drejtorët e drejtorive komunale. Me këtë rast, Aliu ka potencuar se ky projekt është një ndër projektet më të rëndësishëm që kanë pasur banorët e këtij fshati pas dy dekadave të pasluftës. "Jemi pikërisht këtu ku është duke u bërë shpimi i

një pusi të ri shtesë, i cili ka ardhur si kërkesë e vet kryetarit të fshatit, e vet këshillit të fshatit, banorëve dhe bizneseve të Gremës që normalisht se është miratuar nga unë për arsyen se fshati Greme është një fshat që ka një numër shumë të madh të banorëve dhe është ndër fshatrat më të mëdhenj në Komunën e Ferizajt. Po ashtu, ky fshat ka numrin e madh të bizneseve dhe, duke pasur parasysh këto dy fakte, ne kemi vendosur të kemi një burim shtesë, një pus shtesë në

mënyrë që të ketë ujë të bollshëm në shtëpitë, por edhe në bizneset e fshatit Greme", është shprehur Aliu.

Kryetari Aliu është shprehur se në kuadër të këtij projekti do të bëhet edhe renovimi i rezervuarit, shtrirja e gypit si dhe instalimi i kycjeve nëpër shtëpi dhe biznese në fshatin Greme, ku banorët do të kenë ujë të pijshëm. Vlera e projektit është mbi 195 mijë euro, ndërsa punimet në këtë projekt do t'i kryejë operatori ekonomik "Arlindi".

Kryetari Kastrati shërohet nga koronavirusi

KAMENICË, 2 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, i cili, pas testimit të bërë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), kishte rezultuar pozitiv me Covid-19, por është shëruar plotësisht.

Kastrati ka thënë se gjatë periudhës së vetizolimit nuk kishte pasur asnjë simptomë, por ka shtuar se shqetësimi i tij ishte nëse ka qenë bartës i virusit të të tjerët. "Të dashur qytetarë, sipas protokollit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës konsiderohet se jam shëruar plotësisht nga pandemia Covid-19. Janë

bërë 25 ditë që nga kontakti me një person që ka rezultuar pozitiv, 21 ditë prej që jam izoluar dhe 17 ditë nga testimi për këtë virus. Për gjithë këtë periudhë, fatmirësisht, nuk kam pasur asnjë simptomë dhe konsiderohet se kam qenë prej të infektuarve asimptomatik. Shqetësimi im më i madh ka qenë nëse unë kam qenë bartës i virusit të dikush tjetër, sidomos tek ata që mund të jenë më të rrezikuar e me sëmundje kronike", ka thënë ai.

Më tutje, ai ka treguar se tani do t'i rikthehet punës në komunë, duke u bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të mbajnë maska, të mbajnë distancë dhe t'i pas-



trojnë shpesh duart, në mënyrë që ta ruajnë veten dhe të tjerët nga Covid-19. "Në këtë situatë unë jam tejet i lumtur që asnjë

nga kontaktet e mia nuk kanë rezultuar pozitiv, përfshirë këtu familjen e kolegët. Arsyja është shumë e thjeshtë. Kujdesi dhe

respektimi i udhëzimeve nga organet kompetente. Këtë periudhë zyrën e kam zhvendosur në shtëpi dhe kam punuar prej aty, kurse tani do t'i rikthehem punës në komunë për qytetarët tanë. Prandaj, ju lutem të gjithëve, të mendoni fillimisht për veten, familjen e njerëzit që ju rrethojnë. Me vetëm tre hapa të thjeshtë ju ulni rrezikun e shpërndarjes të ta. Vendosini maskat, dezinfektoni dhe pastrojeni shpesh duart, mbani distancë", ka thënë Kastrati.

Deri më tani në Komunën e Kamenicës të infektuar ishin 47 persona, ku nga ta 42 janë shëruar plotësisht, ndërsa pesë raste janë aktive.

Ndërtimi i QKMF-së dhe Emergjencës në Rahovec po shkon drejt fundit

RAHOVEC, 2 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga nënkryetari Fatmir Iska, drejtori Samir Mustafa dhe drejtori i QKMF-së, Jusuf Korenica, ka parë

nga afër ecurinë e punimeve që po kryhen në projektin: "Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Emergjencës në Rahovec". Me këtë rast, Latifi ka thënë se projekti

është përfundimtar. "Besojmë se së shpejti do të përfundojnë punimet për ndërtimin e objektit të ri të QKMF-së dhe Emergjencës. Ne jemi duke investuar në të gjitha fushat e infrastruk-

turës, ndërsa ato në shëndetësi janë një prej prioriteteve tona, ku po japim maksimumin e mundshëm, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për pacientët", ka thënë Latifi.



30 VJET PAS AMBASADAVE, KEQARDHJA MË E MADHE ËSHTË QË NUK U LARGOVA

- Sa herë hapja dritaren e shtëpisë, shihja Gjergj Gjon Palin e Kastriotëve...



Denion NDRENIKA

Më 2 korrik të 30 vjetëve më parë u thye frika ndaj dhunës diktatoriale me shpërthimin e dyerve të ambasadave. Atë ditë e në mbrëmje në mbamendjen time unë isha praktikant kuzhinier te restorant "Elbasani", apo një ish-mensë studentësh tek ura e rrugës së Elbasanit dhe ishte dasma e djalit të ish-ministrit të Mbrojtjes, Prokop Murra. Me shefin e kuzhinës Fatmir Kapedani dhe bashkëshokë, thjesht përgatiteshim për dasmën. Madje mbaj mend që gatova një "qebap në letër". Pas dasmës diku nga 4 e ca e mëngjesit, mora udhën për në shtëpi që e kisha në qendër të Tiranës, saktësisht 2 minuta larg sheshit "Skënderbej". Sa herë hapja dritaren e shtëpisë, shihja Gjergj Gjon Palin e Kastriotëve që mbajti osmanlinjtë 25 vjet larg Evropës, e sot më shëmbëllën njëjtë se sa flakur na ka Evropa ne. Ecur rrugës, diku tek ish-kinema "Partizani", që si shumë të tjera gjatë qeverisjes kryebashkiake të Tiranës nga Edi Rama u shkatërruan ose u dhanë për pallate, njëjtë si 11 fusha futbollit apo qendra rinore,

një "morr" policia, siç i quanim makinat e tyre "Fiat" asokohe, vetëm më përcolli me sytë e policëve pa më ndaluar. Për në shtëpi mbropa ish-ambasadës turke dhe ish-kinema "Republikës", që nga kryebashkiaku Rama, siç ceka më lart, u dha për pallat, kalova pa menduar fare se çfarë ditë nate po humbja dhe assesi që ta kujtoja pas 30 vjetësh. Ambasada e Gjermanisë i priu vendosmërisë për të mos lejuar kthim pas duke shtyrë përpara përpjekjet mbarëpopullore për rrëzimin e diktaturës. Mijëra qytetarë u strehuan dhe u morën në mbrojtje nga ambasadat përkundër diktaturës komuniste që vazhdoi reprezaljet, përfshirë vrasjet në kufi, ndonëse në grahmat e fundit që nga vendosja pas 29 nëntorit 1944. Regjimi komunist u trondit në themele kur demokracitë perëndimore refuzuan të dorëzonin mbi 5 000 qytetarët dhe detyruan autoritetet ta pranonin largimin e tyre nga Shqipëria.

Mirëpo, tash 30 vjet pas ambasadave, keqardhja më e madhe në jetë është që nuk u largova. Me rrethin tepër të ngushtë shoqëror Sokol Blacerin e ndjerë, Sokol Xhunga, Arian Ndreun, Oltion Lulin, Erion Begën, Ened Barimin ishim thujse më shumë se të bindur për të ikur. Madje, kujtoj me të qeshur se si Bega më "sulmonte" se unë arsyetoja

ikjen në ambasadën gjermane apo në Gjermani sepse isha tifoz futbollit me gjermanët dhe unë që i thosha që të shkonim ku të donte ai, edhe në Turqi meqë ambasadën e kishim pranë shtëpisë time, ngjitur me mikun e fëmijërisë të përndjekur politik, familje vuajtëse në Spaç, Ben Bakalli. Mirëpo, në të vërtetë ngecëm edhe pse ishim aktivë, shumë aktivë të padashuruar në asnjë grimë me atë regjim. Madje, bënim plane se si do të iknim nëse hapej kufiri asokohe me përfoljen e shumëzurmëshme për 72 orë apo siç e kishte bërë Fidel Kastro në Kubë. Dhe, unë si "mendplot" merresha me tregimin të shokët të rrugëtimit

të mundshëm në hartë, duke mbetur symbyllur që na u shqyen ambasadat në mes të Tiranës. Shumëkush që na ka njohur asokohe, vërtetë që habitet se si mbetëm dhe nuk ikëm.

Me siguri nuk ishim pjekur siç duhej ose nuk ishim aventurierë të patrembur. Ato ditë diskutonim për veprimtari madhore sportive: Finalen e Uimbëlldonit meshkuj, Brazil-Argentinë dhe Holandë-RFGJ për Kupën e Botës. Natyrisht edhe të shkonim në plazh se pa ne, ose me në ambasadat, plazhi do të merrte fund. Të mendosh që sot pas 30 vjetësh ke gabuar që nuk ike, është në të vërtetë më shumë se keqardhje.

Mjafton të shohim shoqërinë tonë të nëpërkëmbur nga e tërë klasa politike dhe intelektuale, duke mos kërkuar ndjesë për të përdorur ndaj tyre fjalët "të pafytyrë" se përse sot është keqardhje mendimi i moskijes 30 vjet më parë. Edhe më pas po e po! Por, me të vërtetë thjesht ngecëm!

Janë të njëjtët pjesëtarë të familjeve kriminale komuniste që qeverisin jo thjesht politikën, ekonominë dhe gjithçka, por trurin, mendjet, shoqërinë e paaftë të dalë fuqimisht për të pastruar veten. Prandaj nuk e shoh me vend për të thënë apo komentuar që paskërkam shfaqur a shprehur pesimizëm. Kuptojeni që kjo është e vërteta.



Veteranët protestojnë më 9 korrik me moton 'Në mbrojtje të luftës çlirimtare'



PRISHTINË, 2 KORRIK - Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës janë shprehur kundër Gjykatës Speciale me seli në Hagë dhe kanë kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që ta ndryshojë ligjin për specialen, pasi duhet të gjykohe të gjitha krimet dhe gjenocidi i kryer nga Serbia në Kosovë.

Në takimin e mbajtur më 30 qershor është thënë se bërja publike e aktakuzës së pakonfirmuar ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli dhe tregon se Gjykata Speciale është e ndikuar politikisht, që e bën të kundërligjshëm gjithë pro-

cesin.

Organizatata e dala nga lufta e UÇK-së dhe Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës konsiderojnë se propozim-aktakuza është bërë me qëllim të caktuar, për ta penguar procesin e dialogut Kosovë - Serbi, andaj kërkojnë që Kuvendi i Kosovës ta ndryshojë ligjin për specialen, pasi duhet të gjykohe të gjitha krimet dhe gjenocidi i kryer nga Serbia në Kosovë. Me këtë rast, organizatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës kanë bërë me dije se më 9 korrik në Prishtinë do të mbahet një protestë gjithëpopullore me moton: "Në mbrojtje të luftës çlirimtare".

Zjarret në Amazonë shënuan rekord në qershor

BRASILIA, 2 KORRIK - Zjarret në pyjet e Amazonës në Brazil janë shtuar për 20 për qind më shumë në qershor, që është rekordi më i lartë brenda një muaji tash e 13 vjet. Instituti Kombëtar për Kërkime në Hapësirë ka bërë me dije se ka regjistruar 2 248 zjarre, në krahasim me 1 880 të tilla në qershor të vitit 2019.

Një intensitet i tillë në fillim të sezonit të thatësirave ka rritur shqetësimet se zjarret e këtij viti mund t'i tejkalojnë flakët katastrofale të vitit 2019. Sipas aktivistëve, kriza e koronavirusit e përkeqëson problemin. Ata besojnë se zjarrvënia ka të ngjarë të kontrollohet më pak, pasi autoritetet janë të preokupuara me pandem-

inë. Shumë zjarre në Brazil ndizen qëllimisht - disa prej tyre nga fermerët që duan ta pastrojnë shpejt tokën. "Ne nuk mund të lejojmë që situata e vitit 2019 të përsëritet vetvetiu", tha Mauricio Voivodic, drejtor ekzekutiv i OJQ-së "World Wildlife Fund" në Brazil. Zjarret e vitit të kaluar kanë

arritur kulmin në gusht, kur janë regjistruar mbi 30 900 sosh - apo trefishi i numrit në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brazili, pas Shteteve të Bashkuara, ka numrin më të madh të viktimave nga koronavirusi: mbi 60 600. Amazona, e cila shtrihet në shumë vende të Amerikës së



Jugut, por 60 për qind ndodhet në Brazil, krijon rezerva jetike të karbonit, i cili ngadalëson ritmin e ngrohjes globale.

Apeli lejon publikimin e librit të mbesës së Trumpit

NJU JORK, 2 KORRIK - Një gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Nju Jork ka hequr ndalesën për publikimin e librit të Mary Trumpit, mbesës së presidentit amerikan Donald Trump, rreth historisë familjare. Gjykata ka thënë më 1 korrik se do ta heqë ndalesën e vendosur ndaj shtëpisë botuese, "Simon & Schuster", e cila synonte ta bllokonte shpërndarjen e librit "Shumë dhe asnjëherë mjaft: Si krijoi familja ime personin më të rrezikshëm në botë". Libri është planifikuar të

publikohet zyrtarisht më 28 korrik, mirëpo shtëpia botuese ka thënë se mijëra kopje të librit veçse janë shpërndarë nëpër librari. Robert Trump, vëllai i presidentit amerikan, ka kërkuar kufizim në botim të librit, duke thënë se Mary është duke shkelur një marrëveshje të vitit 2001, që ndalon zbulimin e detajeve pas shpërndarjes së pasurisë në familjen Trump. Gjyqtari Alan Scheinkman ka thënë se shtëpia botuese



"Simon & Schuster" "nuk është pjesë e marrëveshjes" andaj nuk vlen bllokimi i publikimit të librit. "Simon & Schuster" ka thënë se Mary, psikologe, ka rikujtuar në librin e saj për "familjen toksike" në shtëpinë e gjyshërve të saj. Javën e kaluar, një gjyqtar ka refuzuar ta ndalojë publikimin e librit të ish-Këshilltarit Amerikan për Siguri Kombëtare, me titullin "Dhoma ku ka ndodhur". Në të besohet se ka detaje të punës së administratës Trump.

Rezultatet tregojnë përkrahje të madhe për Putinin në votimin për reforma

MOSKË, 2 KORRIK - Rezultatet preliminare tregojnë se në plebishitin jodetyrues në Rusi janë përkrahur amendamentet kushtetuese që, mes të tjerash, i hapin rrugën presidentit rus Vladimir Putin të garojë për dy mandate të tjera dhe të mbesë në pushtet deri më 2036. Komisioni Qendror Zgjedhor në Rusi ka thënë se pas numërimit të 98 për qind të votave, rreth 78 për qind e votuesve kanë votuar në të mirë të paketës së miratuar nga Kremli, që

përmban më shumë se 200 amendamente. Sipas agjencisë së lajmeve, "Reuters", 21 për qind e votuesve kanë votuar kundër ndryshimeve. Dalja zyrtare në votime ka qenë rreth 65 për qind, ka njoftuar Komisioni Zgjedhor. Procesi i votimit ka zgjatur për më shumë se një javë, me qëllim të parandalimit të përhapjes së koronavirusit të ri. Putini ka shpallur 1 korrikun, ditën e fundit të votimit, si ditë pushimi, me qëllim të nxitjes së



personave për të votuar. Ella Pamfilova, udhëheqëse e Komisionit, ka thënë se votimi ka qenë transparent dhe se zyrtarët kanë bërë gjithçka që të sigurojnë integritet, mirëpo kritikët kanë kundërshtuar

rezultatit. "Rezultatet e publikuara janë gënjeshtër dhe të rreme", ka thënë politikani opozitar Aleksi Navalny. "Ato nuk kanë asgjë të përbashkët me opinionin e qytetarëve të Rusisë". Navalny u ka thënë mbështetësve të tij përmes një video-incizimi se "nuk do ta njohë kurrë këtë rezultat". Putini ka propozuar ndryshimet kushtetuese më herët gjatë këtij viti dhe ka insistuar në mbajtjen e

referendumit, pavarësisht se një gjë e tillë nuk kërkohet me ligj. Ndryshimi final i këtyre ndryshimeve mundësohet nëse më shumë se gjysma e votuesve mbështesin propozimet. Nëse miratohen, Putini, ish-zyrtari i KGB-së, 67-vjeçar, mund të garojë edhe për dy mandate të tjera si president, pasi t'i përfundojë mandati aktual më 2024. Putini ka udhëhequr Rusinë si president apo kryeministër nga viti 2000.

OBSH-ja nis paralajmërim të ri rreth përhapjes së koronavirusit

NJU JORK, 2 KORRIK - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka nisur një tjetër paralajmërim, duke thënë se pandemia me koronavirus është duke u zgjeruar më shumë se secilën herë tjetër prej kur ka shpërthyer virusi. Vetëm Shtetet e Bashkuara më 1 korrik kanë raportuar 50 000 raste të infektuarve brenda ditës.



Shkalla e infektimit javën e kaluar ka arritur në nivelin më lart, kanë treguar të dhënat e OBSH-së.

Shefi i kësaj organizate, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka thënë se numri i rasteve të infektimit brenda ditës ka arritur në mbi 160 000 në nivel global. Rritja e numrit të infektuarve ka detyruar zyrtarët amerikanë, sidomos në shtetet jugore dhe ato perëndimore, që t'i kthejnë mbrapsht vendimet për hapje të restoranteve dhe plazheve, në

prag të shënimit të pavarësisë së ShBA-së më 4 korrik. Kjo situatë duket se ka ndryshuar edhe tonin e presidentit amerikan Donald Trump për vendosje të maskave. "Unë jam për vendosje të maskave. Mendoj se maskat janë të mira. Njerëzit mund të më shohin duke e vendosur atë" ka thënë ai përgjatë një interviste për "Fox Business".

Trumpi është kritikuar për rezistim të vendosjes së maskës, mirëpo me rritjen e numrit të rasteve të infektimit, ai ka thënë më 1 korrik, "nëse do të isha shumë afër njerëzve, do ta vendosja atë". Kompania amerikane Apple ka njoftuar se do të mbyllë 30 dyqane më 2 korrik, gjysmën prej tyre në Kaliforni.

Mali i Zi legalizon partneritetin e çifteve të gjinisë së njëjtë

PODGORICË, 2 KORRIK - Mali i Zi ka votuar të mërkurën për ta legalizuar partneritetin civil mes personave të gjinisë së njëjtë, duke u kthyer në vendin e parë evropian jashtë Evropës Perëndimore dhe Bashkimit Evropian që njeh ligjërisht çiftet e komunitetit LGBT (homoseksual, lesbike, bisek-


sual dhe transgjini). Ligji është miratuar me 42 vota për në parlamentin me 81 ulëse, ka thënë Blanka Radoseviq Maroviq, drejtore-shë në Ministrinë për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve, për agjencinë e lajmeve "Reuters". Ky ligj ishte kundërshtuar fil-

limisht në korrik të vitit 2019. Ky vendim i Malit të Zi, që është duke avancuar rrugën e tij në negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, është mirëpritur nga liderët. "Hap i mrekullueshëm në drejtimin e duhur për shoqërinë e Malit të Zi, maturinë e tij demokratike dhe pro-

ceset integruese", ka thënë kryeministri malazez, Dushko Markoviq përmes një postimi në rrjetin social "Twitter". Ky shtet, me rreth 620 000 banorë, është bërë anëtar i 32-të i Kombeve të Bashkuara që e njeh një formë të partneritetit civil për çiftet e gjinisë së njëjtë.



TAKIMI HISTORIK NË SHTËPINË E BARDHË: RICHARD NIXON – ELVIS PRESLEY



Pse Elvis Presley në dhjetor të vitit 1970 kërkoi të takohet me presidentin amerikan Richard Nixon? Çfarë kërkonte “Mbreti i Rock’n’Rollit” nga Nixon? Pse Nixon refuzoi ofertën e Presleyit?

Në kohën kur rock muzika vazhdonte të jetë e stigmatizuar me thënien e njohur “sex, drogë dhe rock’n’roll”, mbreti i rockut, Elvis Presley, është takuar me Richard Nixonin, kryetari i atëherëshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës!

Ky takim, ishte sensacion i madh, i cili, në masë të caktuar do të mund të krahasohej me zbritjen e njeriut në Hënë një vit më parë.

Historia e këtij takimi vërtet është shumë e çuditshme. Derisa qëndronte në një hotel të Washingtonit, Elvis Presley, i cili në atë kohë akoma ishte në gjendje të mirë shëndetësore, përkundër të gjithave vendosë t’i drejtohet Nixonit me një letër.

LETRA E ELVISIT PËR NIXONIN

Në të, Presley, pos tjerash thekson: “Unë jam Elvis Presley. Kam një respekt të madh për ju dhe për zyrën tuaj. Kam biseduar me nënkryetarin Agnew në Palm Springs tri javë më parë ku ia

shpreha shqetësimet e mia për vendin tonë. Kultura e drogës, hipie-elementët, SDS, Panterët e Zi etj., nuk më konsiderojnë mua si armiq të tyre apo siç i thonë ata establishmentit. Zotëri, unë mund të jem në çfarëdo shërbimi tuaj i cili do të ndihmojë atdheut t’i tejkalojë problemet e sotme. Unë nuk kam shqetësime dhe motive të tjera përveçse t’i ndihmojë Atdheut tim. Prandaj, unë nuk kërkoi farë titulli apo pozicioni të dhuruar. Unë mund dhe do të bëjë gjëra të mira nëse do të caktohem Agjent Federal dhe unë këtë funksion do ta kryej si duhet duke komunikuar me njerëzit e moshave të ndryshme. Para dhe mbi të gjitha unë jam zbatimës, por krejt çka më nevojiten janë kredencialet federale. Zotëri, unë jam duke qëndruar në Washington Hotel, në Dhomat 505 – 506 – 507. Do të qëndroj këtu sa kohë të nevojitet për t’i marrë kredencialet e Agjentit Federal. Kam bërë studime të thella të abuzimit përmes drogave dhe të teknikave trularëse komuniste dhe vërtet mund të ndihmojë shumë. Jam nominuar për vitin që vijon si njëri nga dhjetë personalitetet e reja të jashtëzakonshme të Amerikës. Do të dëshiroja të takohem me ju, të ju them

vetëm tungjatjeta, nëse ju nuk jeni shumë të zënë”.

NJË COLT 45 DHE DISA FOTOGRAFI FAMILJARE SI DHURATË

Në fund të letrës, Elvis Presley shkruante që për bindjen e tij, Richard Nixon është njëri prej dhjetë personaliteteve të jashtëzakonshme të Amerikës. Po ashtu, Presley shtonte që ka disa dhurata personale për Nixonin.

Me 21 dhjetor të atij viti (1970), në Shtëpinë e Bardhë, Nixon do të pres Elvis Presleyin në takim gjithsesi historik për rockun dhe për historinë politike të Amerikës. Presley i dhuroi Nixonit një Colt 45 dhe disa fotografi familjare. Presley gjatë takimit sërish përsëriti idenë e tij për t’u caktuar Agjent Federal në Byronë e Narkotikëve dhe të Drogave të rrezikshme. Presley dhe Nixon biseduan edhe për telashet e tyre familjare.

Ishte një takim i përzemërt dhe vërtetë i çuditshëm për Shtëpinë e Bardhë. Presley, në këtë mënyrë, dëshmoi që është një amerikan i zakonshëm, i cili çmon lartë presidentin dhe institucionin më të rëndësishëm të politikës amerikane:

Shtëpinë e Bardhë. Zaten, respektin e tij ndaj shtetit amerikan Presley e kishte treguar edhe më parë, kur shërbeu në Armatën amerikane, në bazën e saj në Gjermani.

Por, edhe presidenti Nixon përfitoi nga ky takim: Në këtë mënyrë, ky dëshmoi që nuk është një konservativ i mërzi-shëm i cili nuk di të vlerësojë rininë dhe aspiratat e saja, veçanërisht në vitet e intensifikimit të Luftës së Vietnamit. Nëse ju kujtohet, në filmin epik të Oliver Stonet, “Nixon”, ku rolin e presidentit amerikan e luante Anthony Hopkins, Nixonin bën një takim spontan me studentët amerikanë në Memorialin e Lincolnit, duke provuar t’ju shpjegojë se ai i kupton shqetësimet dhe frustrimet e rinisë, por që edhe ata duhet të kuptojnë pozicionin e tij si President i Amerikës.

WATERGATE DHE VDEKJA E “MBRETIT” TË ROCKUT

Sidoqoftë, takimi Nixon-Presley, përpos disa fotografive historike, nuk solli rezultatin të cilin e dëshironte “Mbreti i Rockut”. FBI nuk iu bind dëshirës së Elvis Presleyit për tu caktuar agjent i cili do të luftonte të keqen në shoqërinë amerikane, e cila, për shu-

micën e udhëheqësve të FBI-së, vinte pikërisht prej rockut dhe Elvis Presleyit. Në atë kohë, ta zëmë, John Lennonit, liderët të The Beatles-ëve të famshëm, nuk i jepej leja e qëndrimit të përhershëm në Amerikë, sepse llogaritej që Lennon është “element subversiv” i cili mund të sjellë telashe të mëdha shtetit amerikan.

Në letrën të cilën me 31 dhjetor të vitit 1970 ia ktheu Presleyit, pas takimit, Nixon pos tjerash shkruante që për të ka qenë kënaqësi të presë Presleyin dhe të dëgjojë propozimet e tij shumë interesante. Nixon iu falënderua për dhuratat dhe i bëri të fala zonjës Priskey dhe vajzës së tyre Lisa.

Lisa, shumë vite më vonë, do të bëhet gruaja e Michael Jacksonit, në një martesë e cila për shumëkënd do të mbetet enigmatike.

Kështu pra përfundoi takimi historik i Elvis Presleyit dhe Richard Nixonit.

Nuk do të vonojë dhe Nixon do të detyrohet të japë dorëheqje nga posti i presidentit të Amerikës për shkak të aferës Watergate. Në gusht të vitit 1977, Presley do të vdes në vendlindjen e tij, si pasojë e përdorimit të tepruar të drogës dhe alkoolit. Por, popullariteti i Presleyit është i njëjti si dikur... /Telegrafi/

E jashtëzakonshme

Tornado gjigante në sipërfaqen e diellit



Mbi sipërfaqen e diellit krijohen tornado gjigantë, me përmasa sa të kontinentit evropian. Masat e mëdha të gazit me temperaturë tejte të lartë që shtrihen për mijëra e mijëra kilometra në atmosferën e yllit tonë krijohen nga fushat magnetike dhe kohëzgjatja mund të jetë disa minuta. Shkencëtarët kanë arritur t'i vëzhgojnë falë spektrometrit Ibis, që është i instaluar pranë teleskopit diellor "DsF" në New Mexico në SHBA. Ekspertët shpjegojnë se këta tornado lidhin shtresa të

ndryshme të atmosferës së Diellit, duke shërbyer edhe si kanale për transportimin e energjisë drejt pjesëve të jashtme. Imazhet e mbledhura kanë bërë të mundur që studiuesit të realizojnë një hartë tredimensionale të fushave magnetike që lëvizin në brendësi të tornadove diellorë. Ky studim ka një rëndësi thelbësore për t'i kuptuar mekanizmat e ngrohjes së këtyre shtresave të atmosferës dhe ndikimin në përshejtimin e erës diellore, që ka një influencë të madhe mbi Tokën.

BARSOLETA E DITËS



Doktori: Merre këtë ilaç dhe pi pesë lugë në ditë.
Biondina: Më fal doktor, por si t'ia bëj që i kam vetëm katër lugë?
Doktori: Ilaçet pihet me një lugë, por pesë herë në ditë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Ish-bosi i Formula 1 bëhet baba në moshën 89-vjeçare



Bernie Ecclestone, ish-bosi i Formula 1, është bërë baba për herë të katërt në moshën 89-vjeçare. Bashkëshortja e tij Fabiana Flosi, 44 vjeç, solli në jetë anëtarin më të ri të familjes, djalin Ace. "The Sun" raporton se lindja zgjati vetëm 25 minuta. Çifti po qëndron në shtëpinë e tyre në Zvicër. I sapolinduri Ace është djali i parë i miliardarit. Nga martesat e mëparshme, Bernie Ecclestone ka tri vajza. Ish-bosi i Formula 1 ka grumbulluar një pasuri prej 3.1 miliardë dollarësh nga përfshirja në garat e makinave. Bernie

Ecclestone ka lindur në Suffolk të Britanisë në vitin 1930. Ai është djali i një peshkatari. 89-vjeçari filloi punë për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore në një industri gazi dhe detyra e tij ishte ta kontrollonte pastërtinë dhe cilësinë e gazit. Në vitin 1949 mori pjesë për herë të parë në garat me makina në Formula 3. Përfshirja në një aksident e detyroi atë që të tërhiqej nga garat në pistë. Bernie u angazhua në investime në pronë, të cilat rezultuan të suksesshme. Pas kësaj, u angazhua në Formula 1 duke marrë rol menaxheri.

FOTO E DITES



Ndërgjegjësohen deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, vendosin maska kundër Covid-19.

| | | | | | |
|---|--|--|---|---|--|
|  <p>DASHI Kjo e enjte do të jetë e mbushur me nervozizëm gjatë së cilës do të përballeni me probleme të vështira, të cilat do të shkaktojnë edhe përplasje me personat që nuk duan t'ju dëgjojnë.</p> |  <p>DEMI Do të jetë një ditë mjaft pozitive edhe pse iu druheni ndryshimeve që janë në proces. Mos i lini mundësitë t'ju shpëtojnë.</p> |  <p>BINJAKËT Sugjerohet ta dëgjoni zemrën tuaj, pasi dashuria është streha ku ndiheni më mirë edhe kur përballeni me probleme profesionale.</p> |  <p>GAFORRJA Gjatë kësaj dite mund të ketë probleme të natyrës praktike, të cilat do t'ju shkaktojnë shumë stres. Çdo gjë që do të bëni do të gjykohet nga të tjerët.</p> |  <p>LUANI Sfera sentimentale parashikohet mjaft e favorshme. Edhe sa i takon punës mund të sistemoni disa gjëra, ndaj mundohuni që të mos i lini mundësitë t'ju ikin nga duart.</p> |  <p>VIRGJËRËSHA Ka ardhur momenti për t'u marrë me projekte të reja, ndaj përqendrohuni mirë me atë që duhet të merreni.</p> |
|  <p>PESHORJA Mund të lindin tensione në raportet sentimentale. Mundohuni të kuptoni më mirë se çfarë dëshironi në mënyrë që t'i shmangni debatet e kota.</p> |  <p>AKREPI Mundohuni vetëm që të mos keni shumë kërkesa në sferën profesionale, pasi ko është një periudhë jo shumë e favorshme, ndaj duhet të kënaqeni me atë çfarë keni.</p> |  <p>SHIGJETARI Bëni mirë që t'i shmangni gënjeshttrat ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes, edhe pse mund ta bëni për t'i mbuluar pikat tuaja të dobëta.</p> |  <p>BRICJAPI Parashikohet një ditë e mbushur me nervozizëm, gjatë së cilës mund të ketë debate dhe tensione. Raportet ndërpersonale mund të jenë në rrezik.</p> |  <p>UJORI Do të përjetoni momente nervozizmi, por këshillohet që të mos reagoni ndaj provokimeve. Do të ndieni një dëshirë të madhe për të qenë i lirë.</p> |  <p>PESHQIT Kush ka përjetuar një krizë së fundmi duhet të mundohet që t'i lërë pas gjërat e së shkuarës dhe të shohë përpara.</p> |

Capital T mban orë dore në vlerë prej 12 mijë eurosh



Capital T po bën jetë të shtrenjtë. Reperi njihet si një ndër emrat e estradës i cili shpenzon shumë për pamjen e jashtme. Trimi ka shpenzuar 12 600 euro për një orë dore të markës "Rolex". Mirëpo nuk duhet harruar

të përmendet se reperi është një prej emrave të estradës i cili u ndihmon shumë familjeve në nevojë. Disa raste janë bërë publike, mirëpo thuhet se Capital T ndihmon edhe nëse nuk bëhet kjo e ditur në rrjete sociale apo media.

Ish i dashuri i Melania Trumpit thotë se i ndau ushtria



Gruaja e të parit të Amerikës, Melania Trump, tërheq vëmendjen kudo që ajo shfaqet, ndërsa detajet e jetës së saj private vazhdojnë t'i interesojnë publikut. Ndërsa një nga të fundit është deklarata e ish të dashurit të saj, i cili i ka treguar publikut se ku u takuan dhe pse u ndanë. Peter Butoln, një gazetar nga Sllovenia, ishte në një lidhje dashurie me zonjën e parë të Shteteve të Bashkuara, Melania Trump, derisa ajo ende nuk ishte e njohur dhe jetonte në Slloveni. Të dy pastaj shkuan në shkollë të mesme. "Ne kemi qenë në një lidhje për tre muaj. Mbjaj mend sak-

tësisht, shkolla kishte mbaruar dhe vera ishte para nesh. Në atë kohë i gjithë ekipi u mblodh në Tromostovlje në Lubjanë. Melania erdhi edhe me miqtë e saj. Unë shkova në shkollë të mesme dhe ajo shkoi në shkollë të mesme për dizajn", ka thënë ai. Ai ka shtuar se ishte 18 vjeç e gjysmë, ndërsa asokohe Melania ishte vetëm 17 vjeçe. Ai ka thënë se në takimin e tyre të parë kishte shkuar në banesën e Melanias, ku ajo jetonte në atë kohë. "Lidhja jonë u nda nga ushtria, për të cilën shkova të shërbeja në Jastrebarsko. Që atëherë nuk jemi dëgjuar më me njëri-tjetrin", ka thënë ai.



Morena sërish beqare, ndahet nga i dashuri pas një kohe të shkurtër

Morena Taraku ka pranuar pak javë më parë se ndodhej në një lidhje të re dashurie, pas ndarjes nga biznesmeni iranian Sasha Sobhani. Lajmin e kishte konfirmuar vetë këngëtarja përmes një reagimi në rrjete sociale, ku shkruante se po shijonte romancën e re dhe se ndihej e lumtur. Mirëpo, duket se gjërat nuk kanë shkuar mirë me partnerin, të


cilin Morena vendosi ta mbajë larg vëmendjes së mediave. Së fundmi, ajo ka ndarë një foto në "Instastory", në të cilën shkruhet: "Të jesh single nuk do të thotë që je i/e dobët, do të thotë se je i fortë mjaftueshëm për të pritur atë që meriton". Kaq ka mjaftuar të spekulohet se këngëtarja i ka dhënë fund lidhjes disamujore.

Një milion dollarë për një fjalim, ja si do të fitojnë para Meghan dhe Harry



Tanimë që janë larguar nga familja mbretërore, ish-Duka dhe Dukeshja e Sussex duhet të gjejnë një mënyrë të re për të bërë para. Së fundmi mësohet se ata do të paguhet 1 milion dollarë për çdo fjalim, leksion apo ligjëratë që do të mbajnë. Çifti i shumëpërfolur kanë punësuar një menaxher

për të nënshkruar një kontratë me "Harry Walker Agency", një kompani me të cilën punojnë folës të tjerë të njohur si Barack dhe Michelle Obama, Bill dhe Hilary Clinton dhe Oprah Winfrey. Ata do të japin leksione mbi ngjarje të rëndësishme sociale, raporton revista "Town & Country".



Moikom Zeqo, mistika e rrethuar me dritë blu

Nga: Xhevair Lleshi

Sot ndoshta tingëllon e çuditshme dhe pse jo mund ta quash edhe lajthitëse, por *Anima Mundi* erdhi jo thjesht si titull libri që Ai e mbante në duar si një gjë të rrallë, ngaqë i dhuronte të qeshurën si diçka të shenjtë, e përpunuar në të gjitha tiparet burrërore të fytyrës së eshtërt. Kjo m'u skalit në vetëdije sa dëgjova mëngjesin e së hënës për humbjen e tij. Dikur, jo larg, teksa shqyrtonim një tjetër vepër të tij ai mbeti tek një kompozitë: *populli imagjinar*. Atij i përkasim? A e prishin dot, thua, me buldozerë? Se populli nuk rroposet as edhe me kujtime të ëmbla, jo më me dhunë. Po e shihja në sy si t'i zbuloja një dritë tjetër. Dhe m'u bë se e zbulova. Një rreze blu, e shkurtër, që depërtonte përhumbshtëm në ajër dhe mbetej aty. Një varg i tërë figurash, si njollat e Rosharshit, madje në përfytyrim më ka mbetur me buzëqeshjen e përndritur e të veçantë. Të dyja u bashkuan dhe mbetën ashtu, bashkë: rrezja e syve të tij dhe përfytyrimi i zbuluar nga buzëqeshja. Do të doja t'i bashkoja si një tingëllimë që formësonte mistikën e tij të jashtëzakonshme, herë i vjetër sa bota dhe herë i rinuar befas. Atë e ka dhe tani që po shkruaj,

natyrisht para meje, me syrin që di të shohë nëpërmjet besimit. Me botën e hedhur supeve dhe me buzëqeshjen e çiltër, aq të sinqertë, ku edhe vetë mistika ndihej ngushtë, duke kumtuar ndryshime të thella, edhe pse lundronin në sipërfaqe rrëmujshëm. E vura re papritur teksa kapej me veten, domethënë me mistikën e tij, ku orët lart s'qenë më të tijat, ku biseda e lirë përkthehej si poezi shkruar në alfabetë të panjohur ende, ndërsa e tërhiqte pa masë e shkuara shqiptare, rrëfimi, historia, si një lloj shpërfaqjeje shpirti, thjesht *Anima Mundi*, shprehur në prizmin e një shqiptarie të amshuar. Ulur në kafe *Libri* të lirë dhe me ajsbergun e tij, thua se edhe poetika, edhe mistika fluturojnë majave, duke i lënë përjetësisht të fshehura thëllësitë. Se të dyja fitojnë vlerë tjetër kur hapin flatrat për t'u lexuar me urë. E kisha përpara mistikën, tek rrezja e shkurtër blu e syrit të tij, të cilën tashmë ia shihja konkretisht, por nuk ia zija ngoje sepse kisha frikë mos ma fshihte. Se ai që prodhon një ideale të tillë me vlerë konkrete, me siguri do edhe ta fshehtë. Më bëhej herë-herë edhe si një mrekulli poetike dhe qetë-qetë po i besoja kësaj mistike. Ai mbështetej tek librat e nxjerra prej çantës dhe ashtu si nëpër mjegull frymëzohej,

ikte nga tryeza, bëhej një me shpirtin e Frederik Rreshpjes, ndillte dy vargje nga Roland Gjoza, vinte në shtrungë Sulejman Maton, gërricej me Visar Zhitin, përtypte Uollt Uitmanin e famshëm: kundërshtoni shumë dhe binduni pak, se bindja e verbër ju çon në skllavëri të plotë. Ah Skënder Luarasi, kushedi ç'do të ketë britmuar teksa ia zbuloi thesararin atij demiurgu në atmosferën përplot tym e amë në skarën e prushtë, pastaj merrnim rrugët vargjet e prera me thikë dashurie nga Fasli Haliti... Ne ishim të dy, por aty vinin gjithë poetët. S'bënim gjë tjetër, veç zhbironim në kaltërsi emra të mëdhenj veshur me një vel mistike të habitshme. Mistika e tij nuk që dekadencë. I zgjedhuri i Kuazimodos, i Lorkës, i... Një mistikë e lirë, edhe me diell të zemëruar që drita dhe nxehtësia çoheshin aq dëm... Mahnitja e tij intelektuale, kurrë e dalluar nga jashtë brenda, po me një shpërthim të mrekulluar nga brenda jashtë, bëhej mbështetje e fortë për mistikën e tij antike, mesjetare, po edhe për mistikën e sotme, që shfaqej e habitur, që s'pyeste ku hynte, por dëgjonte pëshpërimat e adhuresve, tetrur në gjakun e ëmbël moikomian. Edhe aty futej ajo mistikë elegante, ndonëse me njëfarë

ndrojtje, përmytur nga shumë dritë, shoqëruar me pak fjollë tymi që i jepnin kolorit të paparë tablosë së freskët. Mistika e tij kurdoherë e vëmendshme shfaqej si portret pikturë, si peizazh, si lexim model i një teksti të vjetër, pa i përzier botët edhe pse ato kishin lindur brenda rrëmujës së vërtetë thurur me fije aq elegante. Kjo mahnitje e tij intelektuale kishte aroma ngacmuese, krejt të bëra fir nga ëmbëlsia e tij e veçantë mashkullore. Mistikën ato çaste e fuste nën det, thellë, për ta shqyrtuar me poezinë, rrëfimin, tronditjen dhe kompetencën e arkeologjisë nënujore. Aty autoriteti bëhej edhe më i mistershëm, gati për të thyer edhe vetë besën. Që atë çast e kuptoje se mistika dhe adhurimi i tij kishin shije që kanë të bëjnë me dritën, me errësirën e pamjaftueshme (sepse mistika e dëshiron errësirën kurrë të plotësuar...), me kundërmimin e luleve, vështirësinë që ngjeron bashkë me krijimin (asnjë krijim, sado i bukur qoftë, nuk i shmanget dot dhimbjes, luftës, shpirtit dhe dalldisjes së përkorë), sepse errësira ka dritë blu brenda, dritën kristaline të syrit të tij që përmbledhte gjithë Adriatikun e Durrësit të tij. Ai nisej të zbulonte diçka por gjithnjë gjente tjetër gjë, hutohej i mahnitur

dhe harresa (kjo mrekulli e jetës) e çonte në shtigje që s'i kish vërejtur ndonjëherë, duke e kthyer nga rruga për ku qe nisur, pastaj mbërrinte në finishin e çdo poeti: në limanin e dashuruar. Në çdo pikë të kësaj rruge, ulej, rrinte pak, çlodhej, ngrinte lart vështrimin ëndërrimtar dhe studente ç'i dilte përpara, ndonjëherë duke i krijuar probleme sepse nuk bindeshin lehtë, siç do të donte kushdo, madje prisnin një kohë tjetër për t'u takuar sërish... Atëherë zbriste në tokë, me mjegullën si aureolë, sado që kapela e tij strehëgjere nuk e lejonte të ngacmohej nga fjalat e lehta të qiçërimës. Veç ta vije re: nuk e hapte gojën, po vetëm qeshte me një cep buze, se ai nuk i përmbante dot mendimet, ato i rrëzëllinin vetiu. «Mendimet e tij ishin të mistifikuara, alegoria e tij rëndom donte një përkthyes.» Më shumë e kuptoja kur më lexonte copëza mendimesh, vargje të hedhur në atmosferë, kërkime të thella. Gjithçka ishte nën sundimin e rrezes së tij të padukshme blu. Si deti i thellë, ngarkuar me aq vërtetësi saqë të shkaktonte habi... Më vjen keq që nuk i mbaj mend ato lajthitje të bukura, gjithnjë pranverore, kur shkelte në dhë tjetër, ku shfaqej një copëz dritë e paparë si gjithnjë e kthjelluar, por e mbështjellë me

pak metaforë dhe me grimca metonimie, që s'të ndaheshin pastaj gjithë jetën. Ato vargje t'i shqiptonte duke u dridhur nga emocioni dhe tronditja e mistershme, po ndoshta edhe nga një frikë e pakuptueshme. Moikomi ishte natyrë stoike, një ajsberg i rrallë, me aq shumë butësi dhe ëmbëlsi, një shenjtëri që ecte, vazhdimisht ecte, paksa i kërrusur (duket nga pesha e rëndë e mendimeve (se kërrusjen e udhëheq koka!) dhe të mundimeve, që shfaqej kur belbëzonte me zë të ulët citimet e tij të mrekullueshme dhe jo vetëm nga *Anima Mundi*. Varg i gjatë, përplot dallgë antike, që në të vërtetë ishin malet, shpellat, erërat, kufiri, fushat, narkoza në një trup pa gjymtyrë, me duar në ajër, këmbë në vetëtimë e rufe. Kjo bëhej shpejt drithërimë bëhej emër që s'kish nevojë për mbiemrin, tendosje që i pëlqente shkronjës shqip, mirënjohje për kulturën tonë kombëtare, dijetar që s'i mjaftonte kurrë vetja dhe «funktiononte si institucion». I sëmurë? I drobitur? I mpakur? Jo. Këto janë hipoteza të një bote inekzistente që nuk e kish lejuar t'i humbiste asgjë. Botë e çuditshme, që merrte formën e fjalëve dhe të ideve. Dua të jem i fshehur në një guvë si murgjit e mesjetës, më thoshte. I tillë je, por i kësaj Mesjete që jetojmë... Edhe komunizmi prodhim mesjetar është... Ëndrra e murgjve... Thua? Lexoju dhe do të shohësh. Ato mendime t'i kam thënë të gjitha... Borëtim bore, rrugë të ngushta pa krye, male të larta, humbëtira të thella detare, detarë të pabindur që i tërheq poezia e pazbuluar kurrë, malësorë të gjatë, armë të ngrëna nga vitet si mola, temperaturë koronavirusi në qiell, një gotë që nxit etjen e pashuar, mëngjesi pranveror me vesë të magjepsur e aq të fshehtë e përplot mistikë... Mendime që përshkajnë idetë e tij dhe gjithnjë të mbushura vetëm përgjysmë. Etja e një dijetari të kthjellët nuk mund të shuhej kurrë. Me një dehje stilistikore dhe të papërmbajtur. E bukur si pika e lotit...

Një njeri i ditur si Moikomi Zeqo ishte i pranishëm kudo, në opinione e diskutime, në analiza dhe në entuziazmin e librit të ri, në njohjen e stileve dhe organizimit letrar, në biblioteka e veprimtari ku flitej për librat. Ai binte në sy menjëherë, me sytë xigluës, shpotitës, shpuzë, me një dritë të habitshme, zërin e ngrohtë dhe aq mirënjohës, duke dhënë kurdoherë përgjigje të thukëta. Moikomini nuk e gjeje kurrë vetëm, gjithnjë ndillte e provokonte diskutime mbushur me ëmbëlsi krejt njerëzore dhe sidomos e veçanta e tij falënderuese hidhte një hije tjetër miqësore dhe tejet afruese, që

nuk e pashë kurrë të ngrëfosej. E ku kish kohë ai të merrej me kësi sjellësh?... Libri të rrëmben, të bën për vete dhe ka veç kulturën e tij të lartë dhe domethënëse... Moikomi hynte lehtë në diskutim, dinte të futej në mendimin tënd dhe të diskutonte me ty në heshtje. Po. Me të mund të flisje gjatë kështu...

Atë kohë kur botonte Sinopsitet e tij të shkëlqyera, një libër i përmasave të mëdha dhe bërthama e librave të tij të pafundme, monografi e romane, studime e novela, tregime e poezi, shkrime historike dhe analiza të holla psikologjike, opinione dhe kritikë e ashpër, shqetësim për shkatërrimin arkeologjik të Durrësit, krimi më i madh e i më i shëmtuar në botën shqiptare. Dhe ky diskutim më sjell në kujtesë një vizion të përbashkët për Durrësin e vjetër. Edhe Moikomi, edhe unë, e kishim të njëjtë përfytyrimin për ta parë Durrësin antik poshtë xhamave ku mund të gjenin mundësinë miliona turistë duke parë një mrekulli. Por ky përfytyrim merrte përmasa ideale dhe luftohej mu për këtë qëllim të jashtëzakonshëm... Të këmbëngulje do të thoshte të bëje shumë vjetë burg, ndonëse ne si në burg na dukej vetja. Pa ndonjë dallim të madh midis jetës andej brenda e këndeja jashtë. Por letërsia dhe jeta kulturore sipas Mjeshtrit të Madh Moikom Zeqo ka qenë dhe mbetet rrëmujë e batërdis, ku dominon një art i rëndomtë, ku mungon drama apo komedia shqiptare – e cila në kushtet e prishjes dhe shkatërrimit s'mund të gjejë dot vend, as edhe për një gardërobë të thjeshtë e jo më për atë të mendimit. S'kishte dhe nuk ka punë, s'duket kurrkund dritë, kurse dielli sido-sido shkëlqen, ndonëse i copëtuar në dhembët e politikës.

E takova krejt papritur kur kërkonte një mik të vjetër. Atë mik e kish kapur dalldia, si të thuash një dalldi në përgjithësi. U buzëqesh të gjithëve, me një buzëqeshje përulëse si galdim për tjetrin... Ai, miku i tij i vjetër kish filluar të hidhte rrugë, sa t'i jepej mundësia, batuta të çmendura që të robëronin... Nuk e takoi dot dhe duket se i mbeti peng... Kurse mua s'më ndahen nga kujtesa takimet me të. Diskutoni për një prirje që unë e kam vënë në qendër të studimeve të mia: Bashkëjetesa paqësore e mrekullueshme fetare në botë, thelbi i trashëguar në breza tek populli shqiptar, aty ku gjeti shtratin, sepse e mbajti gjallë nga trashëgimi i Perandorisë Osmane. Moikomi thoshte se ne e kemi çelësin e zgjidhjeve në politikë. Thjesht. Jemi në kohën e duhur të gjejmë pikat e nxehta që na japin mësim nga

vetë historia. Të tilla janë *analogjitë historike* (periudhat e ndryshme historike për të ndërtuar paralele të rëndësishme siç janë Republika e viteve 1920-1927 në Shqipëri dhe po aty Vitet 1944-1948, duke ngulitur gjithnjë në mendje parimin se «çfarëdo marrëdhënieje që të ekzistojë midis dy ngjarjeve historike, ajo nuk varet nga një përkim i saktë i ndodhive, por nga ngjashmëria e problemeve midis tyre», sepse «historia mëson nëpërmjet analogjisë, jo nëpërmjet identitetit.» Në studimin e çështjeve të politikës së jashtme, është i domosdoshëm ndërgjegjësimi në kontekstin historik. Në veçanti, duke qenë se një popull e përcakton identitetin e tij «përmasë vetëdijes së një historie të përbashkët, historia mund të përkufizohet si kujtesë e shtetit. Prandaj studimi i historisë së shtetit mund të përdoret për t'i kuptuar ato më mirë. Duke u mbështetur në këtë parim, mund të perceptojmë ngjashmëritë dhe dallimet midis Shqipërisë së sotme me atë të viteve 1920-1927. Në këtë rast, është e domosdoshme të rindërtojmë një rend legjitim


kombëtar. Sido që pengesa kryesore është ekzistenca e një force revolucionare (në vitet '20 forca demokratike e Fan Nolit), prapëseprapë mësimi i historisë na tregon se politika është gati e njëjtë në pozicionin e ngurtë, domethënë të dyja forcat kryesore politike qëndrojnë në pozicionet e tyre të fortifikuara. Roli i thjeshtë i baraspeshuesit nuk mjafton, është e nevojshme që njëkohësisht të ndërtohet një rend i duhur demokratik i baraspeshuar, duke ia shtuar fuqisë revolucionare (që realisht nuk ekziston, me gjithë tendencat e forcave demokratike) si energji e rrezikshme. Por, ndërkohë as duhet ta paragjykojmë...


Dhe pastaj sërish Moikomi futej në botën e librave që i rreshtonte mbi tryezë.

Nuk e kisha shkuar nëpër mend se bisedat mes njerëzve të letrave, edhe në spital, janë të këndshme. Diku ngriti krye ballafaqimi mes rretheve letrare dhe rretheve të lexuesve. Unë drejtoj një rreth lexuesish tha njëri prej miqve të mbledhur në

spital, ditëve të shtrimit. Librat. Diskutimet rreth tyre. Mund të jenë rishtar leximesh, po edhe ithtarë aksidentalë dhe pa shkak i leximeve. Për atë që nuk lexon s'ka dhembshuri. Po të jetë libër poetik poezitë duhen thënë përmendësh. Si në teatër. Dhe shqiptohen poezi, poezi që s'i shkruan vetë, por poeti, ama ai i lexon, i thotë përmendësh, poezi pafund... Dhe diskutimi nuk e gjen dot pikën, madje nganjëherë... Dhe shpërthen e qeshura e sinqertë.

Po e shihja Moikomini në profil. Mjekra e dendur, mollëzat e faqeve kishin nisur të dilnin më pah, sytë paksa të lodhur si shpuzë e mbuluar, shihte larg, tej dritareve. Edhe malet tutje duket sikur rrinin në këmbë, përngrehur. Edhe ne aty rreth tij. M'u duk si profil shenjtori, donte të çohet në këmbë dhe qahej për dikë ose për veten... Për veten më mirë. Do të donte ta kthente një faqore por sikur ngurronte dhe vështrimi pa skaj të trembte. Profili i një shenjtori do të mbetet përjetshëm tek ne miqtë e tij... Tiranë, 16 qershor 2020





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Butrint Ahmeti i duhet nënshtetësia shqiptare për ta vazhduar karrierën në Evropë

Talenti i madh i futbollit në Kosovë, Butrint Ahmeti, me cilësitë që ka, e ka të garantuar të ardhmen në futbollin evropian, por pengesë për këtë po bëhet moslejimi i lirë i qytetarëve të Kosovës. Butrinti ka marrë edhe letërbështetjen nga MKRS-ja dhe shpreson se kërkesa e tij për t'u pajisur me pasaportë shqiptare, e cila është në Presidencën e Shqipërisë, do të aprovohet



madhe që kanë bërë dhe po vazhdojnë të bëjnë, sidomos me gjeneratat e reja. "Jam shumë falënderues ndaj trajnerëve me të cilët kam punuar dhe vazhdoj të punoj si Besim Ademi, Mustafë Pronaj dhe Labinot Haziri, të cilët nuk kanë kursyer asnjë minutë që rezultatet të mos më mungojnë mua dhe lojtarëve të tjerë", ka shtuar Butrinti.

Edhe futbollisti i talentuar, si çdo tjetër futbollist në botë, synim ka daljen në futbollin evropian. Ai është provuar në dy klube gjermane dhe një të Suedisë, por problemet me vizë kanë qenë një problem për ta realizuar ëndrrën. "Kam qenë në prova në Borussia

vendosjen në një nga këto ekipe. Shpresoj të hapen rrugët që talentet e shumta që janë në Kosovë ta kenë më të lehtë zhvillimin dhe daljen në Evropë", ka deklaruar Ahmeti.

Pavarësisht kësaj, talenti Ahmeti është i vendosur të mos heqë dorë nga ëndrra e madhe që një ditë të luajë në një klub të madh evropian dhe t'i bëjë krenar të gjithë shqiptarët. "Do të vazhdoj të punoj me përkushtimin më të madh, sepse jam i bindur se dyert për të dalë në Evropë do të hapen dhe shpresoj që në të ardhmen të luajë në ndonjë klub të madh. Familja ime gjithmonë ka dhënë kontribut të madh për vendin në forma të ndryshme, derisa unë mendoj ta vazhdoj

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 KORRIK - Butrint Ahmeti është një nga talentet e mëdhenj në futbollin e Kosovës që po kërkon me ngulmë shpërthimin në arenën

futbollit e dashuroj se tepërmi dhe nuk e shoh jetën pa futboll. Në vitin 2010 kam filluar të merrem me lojën time të zëmrës në akademinë e futbollit 2 Korriku nga Prishtina, ku edhe sot jam pjesë e këtij klubi. Kemi arritur të

shpallur kampionë", ka thënë Ahmeti.

Pavarësisht prej talentit që ka një futbollist, atij i duhet një punë e madhe për të arritur të nxjerrë në pah cilësitë e tij, prandaj Ahmeti u është falënderuar trajnerëve në Klubin e 2 Korrikut për punën e



Munchengladbach, Wupertal WSC, së fundmi në Malmo FF, por telashet me dokumentacion po na pengojnë në zhvillimin dhe daljen në Evropë. Provat i kam kaluar me sukses, por telashet me vizë ma kanë pamundësuar angazhimin jashtë. Këtë e konfirmon edhe menaxheri im Leonard Paqarada, i cili ka marrë konfirmimin se provat janë kryer me suksese, por mungesa e dokumentacionit për udhëtim të lirë e ka pamundësuar edhe

këtë traditë, por nëpërmjet sportit", ka shtuar ai.

Butrinti ëndërron të luajë në futbollin evropian, por i duhet pasaporta e Shqipërisë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë ia ka lëshuar letërbështetjen, por vendimin përfundimtar do ta marrë Presidenca e Shqipërisë. Butrinti beson se shteti shqiptar do t'u dalë në ndihmë bijve të vetë në mënyrë që ëndrra e madhe të mos i mbetet e perealizuar.



ndërkombëtare. Ahmeti, që aktualisht është pjesë e 2 Korrikut, ka lindur në Ferizaj më 21 janar të vitit 2004. Futbollisti nga Shtimja para dhjetë vjetësh e filloi karrierën e futbollit në akademinë e Klubit 2 Korriku nga Prishtina dhe ende vazhdon të jetë pjesë e këtij klubi me një histori mjaft të lavdishme në futbollin e Kosovës. Djaloshi 16-vjeçar me modesti për "Epokën e re" ka treguar për hapat e parë në lojën e futbollit. "Lojën e

fitojmë shumë trofe duke filluar nga regjioni i Prishtinës, kampion i Kosovës me grupmoshat U13, U15 dhe U17 në Superligën e Kosovës si dhe në vitin 2015 jemi shpallur kampion ballkanik në Izmir të Turqisë, ndërsa më vonë edhe në Strumic të Maqedonisë jemi shpallur kampion i Ballkan kupës. Vlen të përmendet se në finale kemi luajtur dy skuadrat shqiptare, 2 Korriku - Shkëndija, në të cilën lojë ne kemi shënuar fitore dhe jem

FHK-ja paraqet skuadrat që do të marrin pjesë në garat evropiane

PRISHTINË, 2 KORRIK - Pas përfundimit të garave të edicionit 2019/2020, Federata e Hendbollit e Kosovës ka prezantuar në Federatën Evropiane të Hendbollit listën e skuadrave që e kanë të drejtën e paraqitjes në kupa evropiane të edicionit të ardhshëm. Kampionët, Besa Famgas te

hendbollistët dhe Ferizaj te hendbollistët, janë paraqitur nga FHK-ja për të garuar në Ligën Evropiane (EHF European League). Finalistët e plejofit, Prishtina (meshkujt) e Istogu (femrat) janë paraqitur për të garuar në Kupën Evropiane (EHF European Cup). Në Kupën Evropiane të

drejtën e paraqitjes e kanë edhe Trepça e Kastrioti (meshkujt) si dhe Vushtrria e Prishtina (femrat). Por, u takon klubeve që ta konfirmojnë paraqitjen në gara evropiane dhe t'i plotësojnë kriteret që i kërkon EHF-ja. Afati për ta konfirmuar pjesëmarrjen nga ana e klubeve është deri më 13 korrik.



Spaqi: Ide e mirëseardhur, me tetë skuadra Liga do të jetë shumë interesante

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ideja e formimit të Ligës Kosovë - Shqipëri po përkrahet nga komuniteti i basketbollit në Kosovë. Kjo ligë shihet si një mundësi për t'i parë skuadrat më të mira të dy vendeve, ku do të ketë rivalitet në fushë dhe

tifoze në tribuna. "Është ide e mirëseardhur. Do ta shohim edhe anën financiare të klubeve për shpenzime, siç është transporti dhe shpenzimet e tjera. Katër ekipet më të mira të Kosovës dhe katër më të mirat e Shqipërisë të krijojnë

një ligë kombëtare është një ide e realizueshme. Besoj se liga do të jetë shumë e mirë, pasi do të luajnë tetë skuadrat më të mira të dy shteteve. Ndoshta më vonë do të mund të inkuadrohej edhe ndonjë skuadër nga Maqedonia Veriore", ka thënë

përfaqësues të FBK-së, ish-basketbollisti Valentin Spaqi. Drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Shqipërisë janë duke punuar intensivisht për jetësimin e ëndrrës të formimit të Ligës Kosovë - Shqipëri.



Ministrja Dumoshi e kryetari Haziri vunë gurthemelin e stadiumit ndihmës në Gjilan

GJILAN, 2 KORRIK - Ministrja Vlora Dumoshi bashkë me zëvendësministren Valdete Bajrami, gjatë vizitës në Gjilan, ishin të pranishme për vënien e gurthemelit të stadiumit ndihmës në lagjen "Arbëria" në Gjilan.

Ministrja Dumoshi ka thënë se investimi në fushën ndihmëse në lagjen "Arbëria" kap koston e 550 mijë eurove. Me këtë rast, ministrja u bëri thirrje të rinjve dhe organizatave rinore që të aplikojnë për mbështetje nga fondi emergjent 5 milionësh që është ndarë për MKRS-në për kulturë, rini, sport e trashëgimi. Ky fond do të përfshijë vende pune për të rinjtë, në fusha që ndërlidhen me kulturën, rininë e sportin, me ç'rast të rinjtë ftohen të aplikojnë përkitazi në projekte programore të Ministrisë. Me këtë theksoi që synohet që pjesën që i përket rinisë përmes këtij fondi ta përkthejnë në vende pune për të rinjtë. "Sot ndodhemi në komunën e Gjilanit, ku në programin tonë, bashkë me Federatën e Futbollit, shpallim programin për avancimin e sportit në përgjithësi, në veçanti për futbollin. Në katër komuna do të investojmë rreth 4 milionë euro. Fusha ku ndodhemi sot ka koston prej 550 mijë eurosh", ka thënë Dumoshi.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se të rinjtë e Gjilanit




do të shkollohen e stërviten në këtë stadium, i cili është i treti në Gjilan. "Ministrja dhe zëvendësministrja janë në Gjilan për t'i parë punimet në infrastrukturën sportive dhe për ta inauguruar stadiumin ndihmës të Gjilanit. Të rinjtë tanë do të shkollohen e stërviten, por edhe klubet do t'i kryejnë stërvitjet në këtë stadium. Shpresoj që kjo t'ju shërbejë si motivim për lojën e bukur që do të zhvillohet këtu", ka thënë Haziri.

Stadiumet në fjalë janë projekt i përbashkët i MKRS-së, FFK-së dhe komunave dhe ndërtohen për ekipet e futbollit të cilat garojnë në

Super Ligën e Kosovës. Gjashtë fusha ndihmëse janë ndërtuar dhe gjashtë pritet të ndërtohen në tërë Kosovën. Ministrja Dumoshi dhe kryetari Haziri kanë inspektuar edhe ecurinë e punimeve në Stadiumin e Gjilanit e ku investimet janë mbi 9 milionë euro. Ky stadium, sipas standardeve të UEFA-s, i takon kategorisë së katërt. Investimet e tjera në Komunën e Gjilanit janë edhe palestra sportive në Zhegër e cila kap vlerën mbi 2 milionë euro, dy fusha të tenisit me vlerë mbi 70 000.00 dhe investimet në Palestrën "Petrit Selishta" me vlerë mbi 400 000 euro.

Hamiltoni ka kërkesë të lartë për ta rinovuar kontratën me Mercedesin

Lewis Hamiltoni kërkon një rrogë prej 40 milionë sterlinash në vit (50 milionë dollarë) për ta rinovuar kontratën me Mercedesin. Kontrata e pilotit britanik, 6 herë kampion bote në Formula 1, skadon në fund të këtij sezoni. Sipas "Daily Mail", kjo shumë e lartë e kërkuar nga Hamiltoni ka bërë që bisedimet për rinovimin e kontratës të ndalojnë në pritje të një kompromisi. Gjatë këtyre viteve me makinën gjermane, piloti britanik ka arkëtuar rreth 224 milionë sterlina nga rroga e tij, duke e bërë atë një nga sportistët më të paguar në Britaninë e Madhe. Hamiltoni, 35-vjeçar, mund të largohet nga Mercedesi në fund të këtij sezoni së bashku me drejtorin



sportiv Toto Wolff, raporton "Telesport". Gjithsesi, drejtuesit e makinës gjermane shpresojnë të arrijnë një marrëveshje me britanikun, ndërkohë që këtë fundjavë nis sezoni 2020 i botërorit të Formula 1. Prej

kohësh pritet se kjo dyshe mund të largohet nga Mercedesi, por ende nuk ka asgjë zyrtare në lidhje me të ardhmen e tyre. Për momentin nuk ka asnjë makinë në gjendje që t'i plotësojë kërkesat e Hamiltonit.

SHKURT

Tmusiq kalon te KK Podgorica

Basketbollisti i Kosovës, Mikaile Tmusiq, i është bashkuar skuadrës malazeze, KK Podgorica. Tmusiqi në dy vjetët e fundit ka qenë pjesë e Sigal Prishtinës, ku ka fituar shumë trofe, derisa para se të arrinte në Prishtinë ishte pjesë e Bashkimit për dy edicione, duke e ndihmuar skuadrën prizrenase ta fitojë titullin e parë në histori të klubit. Tmusiqi në edicionin e ri do të luajë me KK Podgorica, që do të luajë në Superligën e Malit të Zi dhe ABA Ligën 2. Mikaile Tmusiq është pjesë e Përfaqësueses së Kosovës.

Demhasaj kalon te Grasshoppers

Shkëlqim Demhasaj nga sezoni i ri do të jetë pjesë e Grasshopperit. Sulmuesi i Kosovës, pas tri sezonesh largohet nga Luzerni, për t'iu bashkuar Grasshopperit, duke nënshkruar kontratë deri në vitin 2023. Lajmi është konfirmuar nga skuadra e Grasshopperit. "Mirë se vini në Cyrih, Shkëlqim Demhasaj!", shkruan faqja zyrtare e Grasshoppersit.

Griezmann drejt largimit nga Barcelona

Antoine Griezmann po kalon një moment shumë të vështirë te Barcelona, aty ku ai u afrua me shumë bujë në verën e kaluar. Francezi tashmë nuk duket si një titullar te skuadra katalanas, me trajnerin Setien që shpeshherë e ka lënë në stol. Në ndeshjen me Atletico Madridin, sulmuesi u la në stol, teksa u aktivizua vetëm dy minuta në fund, duke ngjallur reagime të shumta. Një nga reagimet ishte edhe ai i vëllait të Griezmannit, Teo, i cili në "Twitter" shkruante: 2 minuta?! Dua të qaj, singërisht". Tashmë fillojnë të qarkullojnë lajme për një largim të mundshëm të sulmuesit nga Barça, me PSG-në dhe klube të tjera nga Premierë Liga që presin ta nisin sulmin për transferimin e francezit.

Guardiola konfirmon se Sane do t'i bashkohet Bayernit

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka konfirmuar se Leroy Sane po e braktis Cityn për t'iu bashkuar gjigantit gjerman Bayern Munchen. 24-vjeçari pritet të nënshkruajë kontratë pesëvjeçare me kampionin gjerman. I pyetur për Sanen para ndeshjes së City me Liverpoolin, Guardiola ka deklaruar: "Duket se ai po shkon, por ende nuk është punë e kryer". "Ka disa probleme të vogla, por duket se ai po shkon në Munich. Ne ia urojmë atij të gjitha të mirat dhe e falënderojmë shumë për vitet e kaluara së bashku. A kërkoi të largohet. Të gjithë e kanë jetën e vet dhe ai vendosi të largohet. Shumë kisha dashur që ai të qëndronte me ne, ai beson se atje do të jetë më i lumtur dhe më mirë", ka deklaruar Guardiola.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania N. SH. T. "Gini Com" Pasjak, Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thertoren dhe përpunimin e mishit në fshatin Pasjak, zona kadastrale Koretishtë komuna e Novobërdës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.07.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Baresha" në fshatin Pasjak komuna e Novobërdës do të organizohet debat publik nga kompania N. SH. T. "Gini Com" Pasjak, Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thertoren dhe përpunimin e mishit në fshatin Pasjak, zona kadastrale Koretishtë komuna e Novobërdës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "n'Shesh" ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810100024 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "n'Shesh" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810100024 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "n'Shesh" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810100024 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 05-20

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontratë për përkthim dhe lektorim të materialeve të OMK-së

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **13.07.2020 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **15.07.2020 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **15.07.2020 ora 14:00.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "AF Consult Switzerland AG Kosovo Branch" ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810871980 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AF Consult Switzerland AG Kosovo Branch" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810871980 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "AF Consult Switzerland AG Kosovo Branch" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810871980 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Nr-4- 111-27015
Datë: 02.07.2016

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika d të Ligjit për Arsim në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, nenit 18 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ 15/2019 të MASHT, Drejtoria Komonale e Arsimit në Lipjan, shpall:

**KONKURS
Për plotësimin e vendeve të punës**

- Drejtor në SHFMU "E. Koliqi" në Babush i M
- Drejtor në SHFMU "Migjeni" në Rufe i Ri
- Drejtor në SHFMU "Fehmi Agani" në Medvec
- Drejtor në SHFMU "17 Shkurti" në Glligove

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për pozitën e drejtorit duhet ti plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi prej 330 ECTS, me së paku pesë (5) vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor, kualifikimi 300 ECTS, 5 vite të shkollimit universitar – Fakulteti katër vjeçar (4) me 240 ECTS, katër (4) vite të shkollimit universitar, të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësis sipas UA për licencimin e mësimdhënësve;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim të aprovuar nga MASHT sipas rekomandimit të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në SHFMU;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të plotësojnë këto dokumente:

1. Kërkesën;
2. Certifikata e lindjes;
3. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
4. Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
5. Dëshmi se nuk është nën hetime dhe dëshmia se nuk ka qenë i/e dënuar për krim dhune ose vepra të pa denja që përfshijnë fëmijët;
6. Dëshmi për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
7. Koncepti i planit zhvillimor të institucionit edukativo - arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkurruar, koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë së paku 10 faqe tekst (një faqe për një fushë) me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12 Arial, koncepti dorëzohet si pjesë e portofolios, por është edhe pjesë kryesore e intervistës;
8. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimin paraprak nga institucion publik kredibil (MASHT, DKA, Këshilli i Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe për arsim);
9. Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon;
10. Portofolion profesionale (shih shtojcën G);
11. Kandidati/ja për drejtor dhe zv. drejtor nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit:

- Drejtori i institucionit edukativo-arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit duke përfshirë:
- Përgatitjen e planit vjetor të punës, panit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimi efikas dhe efektiv të sistemeve informative për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin e mësimdhënësve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe kuadrin tjetër arsimor;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të shkollës, Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve edhe Këshillin e Nxënësve;
- Raporton dy herë në vit para Këshillit të shkollës;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkras për fëmijët/nxënësit, duke përfshirë edhe masat disiplinore ndaj nxënësve;
- Bënë ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga Komuna apo MASHT;
- Çështjet tjera që rregullohen përmes ligjit dhe obligimet që dalin nga Rregullorja e Komunës për arsimin sipas niveleve përkatëse në arsim;
- Vlerësimi i performancës së drejtorëve do të bëhet UA përkatës bazuar në standardet e praktikës profesionale të drejtorëve;

Kohëzgjatja e kontratës së punës: Periudha kohore e kontratës zgjat katër (4) vite, Kandidatëve të zgjedhur për drejtor mund tu vazhdohet kontrata në të njëjtin institucion pa konkurs publik në bazë të rezultateve të vlerësimit të performancës që është i rregulluar me akt të veçantë nënligjor, bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Aplikacionet merren në ndërtesën e KK në Lipjan, në Qendrën për shërbime të qytetarëve sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtin vend,

Kërkesat e pakompletuara dhe të arritura pas afatit refuzohen, nuk shqyrtohen, Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet ligjore.

Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, ueb faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.



RESTAURANT

**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook


www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Kujtim Domuzeti shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Butrint Thaqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Fidan Gashi shpall të pavlefshme dëftesat shf " Arsim Maliqaj " Poslisht.
- ▶ Refki Gjembali shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Ali Maqiteva shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Municipal Assambly Skenderaj

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje
Department of Health and Social Welfare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Nr. _____
Skenderaj 02.07.2020

Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Skenderaj nr.111/01-0022474/20 të datës 25.06.2020 për lejimin e shpalljes së konkursit për vendet e lira të punës për nevojat e QKMF-së në Skenderaj e në përputhje me nenin 7,8,10 paragraf 1 nënparagrafi 2.1, nenit 15 paragrafi 1.2 dhe 3 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, neni 4 i Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, QKMF në Skenderaj publikon këtë:

**KONKURS
PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE**

- I. Titulli i vendit të punës :** Doktor i Mjekësisë Një (1) pozitë
Kategoria dhe grada e vendit të punës:
Koefficienti : **7.20 , H-27**
Orari i punës **40 orë në javë**
Kohëzgjatja e Kontratës sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212

Përshkrimi i detyrave të punës :

Ofron shërbime shëndetësore në QKMF, QMF,AMF –ku është caktuar të punojë sipas orarit të punës të caktuar nga punëdhënësi .
Respekton orarin e punës ardhja , pauza , dalja nga puna etj.
Siguron diagnostifikimin dhe menagjimin efektiv të pacientve duke siguruar edhe referim në Institucionet shëndetësore gjegjëse si dhe në qendrat më të avancuara .
Evidenton dhe përcjellë sëmundjet efektive sipas rregullave të IKSHP .
I përmbahet etikës mjekësore .
Kryen të gjitha punët e Mjekut gjatë orarit të punës .
Bënë përcjelljen e të arriturave më të reja në lëminë e Mjekësisë Familjare .
Të këtë vetëiniciativë dhe ti përmbahet etikës mjekësore .
I raporton për çdo ndryshim dhe problem Përgjegjesit të Njesisë apo shërbimit ku punon.
Sipas nevojës kryen edhe vizita shtëpiake të pacientet kronik.
Sipas urdhërit të përgjegjesit apo Shefit te Sektorit të MF, kryen edhe punë tjera.

Për punën e vet i përgjigjet Shefit të Sektorit MF dhe Stafit Udhëheqës të QKMF-së.
Detajet e tjera të detyrave dhe përgjegjësi do të përshkruhen në kontratën e punës.

Kushtet e Konkursit :

Kandidati/ja të cilët konkurojnë për këto pozita përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të përfunduar :
-Fakultetin e Mjekësisë-Drejtimi i Mjekësisë së Përgjithshme
-Licencën e punës .

Dokumentet e kërkuara :

-Kopja e Diplomës së Fakultetit të Mjekësisë të vërtetuar
-Kopjen e Licencës së Punës të vërtetuar
-Çertifikatën e Lindjes
-Kopjen e letërnjoftimit
-Çertifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime
Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi që kandidat-i/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë.
-Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter –e dëshirueshme.

- II. Titulli i vendit të punës :** Infermier/e të përgjithshëm: tre (3) pozita : Një (1) për Emergjencë, një (1) për QMF Runikë dhe një (1) për QMF Likoc
Kategoria dhe grada e vendit të punës:
Koefficienti : **4.80 , H-68**
Orari i punës **40 orë në javë**
Kohëzgjatja e Kontratës sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212

Përshkrimi i detyrave të punës:

Kryen punët e Infermieri-it/es në kuadër të Sektorit të Mjekësisë Familjare
Bënë pranimin e pacientëve në bazë të fletëz kompjuterike nga Mjeku Familjar
Bënë aplikimin e terapisë parenterale sipas recetës të përshkruar nga mjeku dhe verifikon afatin e skadimit të barit,evidenton dhe protokolon terapinë e dhënë.
Kryen të gjitha punët e Infermieri-it/es në shërbimin ku punon në kuadër të Mjekësisë Familjare.
Bënë llogaritjen,evidentimin e recetave në bazë të injeksioneve të dhëna.
Kryen punët e Infermieri-it/es si regjistrimin dhe protokolimin e dokumentacionit,recetave etj.
Bënë ndarjen e pacienteve me sëmundje infektive,kronike dhe atyre me urgjencë.
Kujdeset për konfidencën e kërkueseve të shërbimeve shëndetësore.
Respekton orarin e punës , ardhja , pauza , dalja nga puna etj.
Jepë raporte mujore për punën e vet.
Kujdeset në kontinuitet për antishokterapinë.
Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të përgjegjesit të Shërbimit ku punon.
Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermieri-it/es dhe Stafit Udhëheqës – të QKMF-së .
Detajet e tjera të detyrave dhe përgjegjësi do të përshkruhen në kontratën e punës.

Kushtet e Konkursit :

Kandidati/ja të cilët konkurojnë për këto pozita përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të përfunduar :
-Shkollën e Mesme të Mjekësisë-Infermieri e përgjithshme
-Licencën e punës .

Dokumentet e kërkuara :

-Kopja e Diplomës së Shkollës së Mesme të Mjekësisë - Infermieri e përgjithshme të vërtetuar
-Kopjen e Licencës të vërtetuar

-Çertifikatën e Lindjes
-Kopjen e letërnjoftimit
-Çertifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime
Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi që kandidat-i/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë.
-Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter – e dëshirueshme.

III. Titulli i vendit të punës : Depoist/e

Kategoria dhe grada e vendit të punës:
Koefficienti : **4.80 , H-68**
Orari i punës **40 orë në javë**
Kohëzgjatja e Kontratës sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212

Përshkrimi i detyrave të punës:

Bënë furnizimin e QKMF (QMF dhe AMF) me material për higjienë, material teknik dhe me material tjetër shpenzues-hargjues për zyre dhe ordianca,letra ,libra të protokolit dhe fletore tjera për Administratë dhe shërbime,njësi dhe sektore të QKMF-së (QMF,AMF).
Jepë material tjetër sipas kërkesave të punonjësve të QKMF-së.
Mbanë evidencat e shpenzimeve të materialit shpenzues .
Evidenton nevojat e shërbimeve të QKMF (QMF,AMF).
Përpilon (planifikon) listen e nevojave mujore, gjashtë mujore dhe vjetore për QKMF (QMF,AMF).
Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të përgjegjesit të Shërbimit ku punon.
Për punën e vet i përgjigjet Shefit-it/es të administratës dhe Stafit Udhëheqës – të QKMF-së .
Detajet e tjera të detyrave dhe përgjegjësi do të përshkruhen në kontratën e punës.

Kushtet e Konkursit :

Kandidati/ja të cilët konkurojnë për këto pozita përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të përfunduar :
-Shkollën e Mesme

Dokumentet e kërkuara :

-Kopja e Diplomës së Shkollës së Mesme të vërtetuar
-Çertifikatën e Lindjes
-Kopjen e letërnjoftimit
-Çertifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime
Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi që kandidat-i/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë.
-Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter –e dëshirueshme.

IV. Titulli i vendit të punës : Shofer/e

Kategoria dhe grada e vendit të punës:
Koefficienti : **4.80 , H-68**
Orari i punës **40 orë në javë**
Kohëzgjatja e Kontratës sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212

Përshkrimi i detyrave të punës:

Bënë transportin e rasteve urgjente të pacienteve në bazë të urdheresës së personit të autorizuar (24h).
Bënë transportin e pacienteve për dializë, si dhe bartjen e ekipit të vaksionimit , mjekëve dhe punonjësve tjerë prej selisë e gjerë në QMF dhe AMF në teren.
Mbanë evidencën ditore dhe mujore të kilometrave dhe shpenzimeve te derivateve .
Ndihmon teknikun në bartjen e pacienteve gjatë transportit .
Mbanë higjienën e autoambulancës.
Kujdeset për aparturën përcjellëse mjekësore .
Bënë dorëzimin me kohë të fletëudhetimeve.
Bënë ndreqjen e defektit të automjetit kur ai është i mundshem të evitohet nga ana e tij.
Bënë paraqitjen e defektit të automjetit të përgjegjesi i shërbimit .
Kryen të gjitha punët sipas profesionit të tij .

Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të përgjegjesit të Shërbimit ku punon.
Për punën e vet i përgjigjet Shef-it/es të administratës dhe Stafit Udhëheqës – të QKMF-së .
Detajet e tjera të detyrave dhe përgjegjësi do të përshkruhen në kontratën e punës.

Kushtet e Konkursit :

Kandidati/ja të cilët konkurojnë për këto pozita përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të përfunduar :
-Shkollën e Mesme
-Patent shofer-kategoria B

Dokumentet e kërkuara :

-Kopja e Diplomës së Shkollës së Mesme të vërtetuar
-Patent shofer-kategoria B
-Çertifikatën e Lindjes
-Kopjen e letërnjoftimit
-Çertifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime
Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi që kandidat-i/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë.
-Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter –e dëshirueshme.

Çdo aplikues duhet të plotësoi dhe dorëzoi dokumentacionin me sa vijon :

-Fletë aplikacionin e plotësuar
-Dokumentacionin mbi përgatitjen dhe kualifikimin profesional/kopje/ e noterizuar(vërtetuar)
Të gjithë kandidatet të cilët hyjnë në listën e ngushtë, do të ftohen në intervistë, dhe për datën e mbajtjes së intervistës do të njoftohen me kohë dhe do të intervistohen nga Komisioni Intervistues .
Aplikacionet merren online dhe të plotësuara dorëzohen përmes Postës në administratën e QKMF-së Skenderaj nga ora 08:00 deri në ora 15:00.
Dokumentacioni i cili nuk ju përgjigjet kërkesave dhe specifikave të Konkursit si dhe dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai që arrinë me vonesë , nuk do të shqyrtohen.

Të drejtë për aplikim kanë të gjithë Shtetasit e Republikës së Kosovës.
Afati për aplikim është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes publike në Gazetë Ditore dhe mjete tjera të informimit.





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Opština Skenderaj



Komuna Skenderaj
Republic of Kosovo
Municipality Skenderaj

Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenje Sociale
Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje
Department of Health and Social Welfare

Glavni Centar za Porodičnu Medicinu
Br. _____
Skenderaj/Srbica, 02.07.2020 g.

Na osnovu odluke Predsednika Opštine Skenderaj br. 111/01-0022474/20, od dana 25.06.2020 god., za odobrenje objavljivanje konkursa za slobodna radna mesta, u okviru GCPM-a Skenderaj/Srbica i u skladu sa članom 7,8,10, stav 1, podstav 2.1, član 15 stav 1,2 i 3, Zakona o Radu Republike Kosova br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Upustva MRSZ br. 07/2017, za regulisanje procedura konkursa u javnom sektoru, GCPM-u u Skenderaju objavljuje sledeći:

KONKURS ZA PRIJEM U RADNOM ODNOSU

- I. Naziv radnog mesta:** Lekar Medicine, jedan (1) položaj:
- Kategorija stepen radnog mesta:
 - Koeficijent **7.20, H-27;**
 - Radno vreme 40 časova nedeljno;
 - Trajanje Ugovora u skladu sa Zakonom o Radu, 03/L-212

Opis radnih zadataka:

Pružava zdravstvene usluge u GCPM-u, CPM-u, APM gde je dužan da radi prema radnom rasporedu kojeg je odredio poslodavac;

Poštuje radno vreme, dolazak, pauza, izlazak sa posla;

Osigurava dijagnostifikaciju i efektivno menageriranja pacijenata, osiguravajući prebačenje u dotičnim zdravstvenim institucijama koja su stručno spremljene;

Održava se lekarske etike;

Izvršava i druge lekarske poslove u toku radnog vremena;

Vrši pratnju novih postignuća u oblasti porodične medicine;

Da ima samoinicijativu i pridržava se lekarskoj etici;

Raportira svaku promenu ili problem menageru jedinice ili službi gde on radi;

Prema potrebi izvrši i kućne posete hroničkih pacijenata;

Prema naređenju ili šefa sektora PM-a, izvršava i druge poslove;

Za svoj rad odgovara šefu Sektora i PM, rukovodilačkoj osoblju GCPM-a;

Ostali detalji zadataka i obaveza će se opisati u radnom ugovoru.

Uslovi konkursa:

Kandidat/kinje koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih predviđenih uslova prema zakonu, treba imati završenu:

- Medicinski Fakultet – pravac opšte medicine;
- Kandidat mora imati licencu za rad,

Potrebna dokumentacija:

- Kopiju Diploma Medicinskog Fakulteta (overena);
- Kopiju Licence za Rad (overena);
- Rodjeni izvod;
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda
- Svaki drugi dokument od raznih trajninga, koju kandidat procenjuje važnom za ovo radno mesto.
- Kandidat koji se prima na posao mora doći i lekarsko uverenje.
- Dokaz o osnovnom poznavanju rada u računaru.

- II. Naziv radnog mesta:** Opšta Medicinske Sestre, tri (3) položaja: Jedan (1) položaj za Emergenciju, jedan (1) CPM Rudnik i jedan (1) CPM Likovac.

- Kategorija stepen radnog mesta:
- Koeficijent **4.80, H-68;**
- Radno vreme **40 časova nedeljno;**
- Trajanje Ugovora u skladu sa Zakonom o Radu, 03/L-212

Opis Radnih Zadataka:

Izvršava sve poslove u okviru Sektora Opšte Medicine;

Izvršava prijem pacijenata na osnovu kompjuterskog papirića o Porodičnog Lekara;

Izvrši aplikovanje palateralne terapije prema lekarskom receptu i verifikuje rok isteka leka, evidentira i protokolira datu terapiju;

Izvršava poslove medicinske sestre na mestu gde radi u okviru Porodične Medicine;

Izvršava obračunavanje, evidentiranje recepta na osnovu datih injekcija;

Izvrši poslove medicinske sestre, u službi gde radi, protokoliranje dokumenata, recepta itd.;

Izvršava razdvajanje pacijenata sa zaraznim, hroničkim i urgentnim bolestima;

Stara se za konfidenciju onima koje traže zdravstvene usluge;

Poštuje radni raspored, dolazak, pauza, izlazak iz posla i td.;

Stara se neprekidno za antišok terapiju;

Izvršava i druge poslove prema naređenju svog pretpostavljenog – pri GCPM-a;

Drugi detalji zadataka i obaveza će se opisati u radnom ugovoru.

Uslovi konkursa:

Kandidat/kinje koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih uslovi predviđenih prema zakonu mora imati završen:

- Medicinsku Srednju Školu Medicinska sestra;
- Kopije licence za rad;

Potrebna dokumentacija:

- Kopiju Diplome Srednje Škole Medicine - opšta medicinska potvrđena;
- Kopije licence za rad overenu;
- Rodeni izvod;
- Kopiju lične karte;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom;
- Svaki drugi dokument od raznih trajninga, koju kandidat procenjuje važnom za ovo radno mesto;
- Dokaz o osnovnom poznavanju rada na računaru – poželjna.

III. Naziv radnog mesta: Magaciner (radnik magacine)

- Kategorija stepen radnog mesta:
- Koeficijent **4.80, H- 68,**
- Radno vreme **40 časova nedeljno;**
- Trajanje Ugovora u skladu sa Zakonom o Radu, 03/L-212

Opis Radnih Zadataka:

Izvršava snabdevanje GCPM-a, CPM i APM sa materijalom za higijenu, tehnički materijal i drugi potrošni materijal za kancelarije i ordinacije, papir, knjige za protokol i druge sveske za administraciju, jedinice, sektore i GCPM-a, cpm i APM.

Daje materijal prema zahtevima radnika u GCPM-a;

Drži evidencije troškova za porošni materijal;

Evidentira potrebe usluga GCMA, CPM i APM-a;

Izrađuje (planira) listu mesečnih potreba, šestomesečnih i godišnjih potreba za GCPM, CPM i APM;

Izvršava i druge poslove prema naređenju pretpostavljenog službe gde radi;

Za svoj rad raportira Šefu administracije i rukovodilačkoj osoblji – GCPM-a;

Drugi detalji zadataka i obaveza će se opisati u radnom ugovoru.

Uslovi konkursa:

Kandidat/kinje koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih uslovi predviđenih prema zakonu mora imati završen:

- Srednju Školu;

Potrebna dokumentacija:

- Kopiju Diplome Srednje Škole;
- Rodjeni izvod;
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda;
- Svaki drugi dokument od raznih trajninga, koju kandidat procenjuje važnom za ovo radno mesto, trebaju priložiti dokumentaciji;
- Dokaz o osnovnom poznavanju rada u računaru – poželjna.

IV. Naziv radnog mesta: Vozač

Koeficijent 4.80, H- 68,

Radno vreme 40 časova nedeljno;

Trajanje Ugovora u skladu sa Zakonom o Radu, 03/L-212

Opis radnih zadataka

Izvrši prevoz hitnih slučajeva pacijenata na osnovu naređenja ovlašćenog lica (24 h);

Izvršava prevoz pacijenata u dijalizu, prevoz ekipa za vakcinaciju, lekara i radnika od sedišta CPM i APM-a na terenu;

Drži dnevnu i mesečnu evidenciju kilometraže i potrošnje goriva;

Pomaže tehničaru u nošenju pacijenata i u toku prevoza;

Drži higijenu u Autoambulancu;

Stara se za prateću medicinsku opremu;

Izvršava predaju na vreme naloga putovanja;

Popravi kvar u vozilo, kada je to moguće, da se popravi od njegove strane;

Prijavi kvar auta kod odgovornog službe;

Izvršava i sve poslove što se tiču njegovoj profesiji;

Izvršava i druge poslove prema naređenju pretpostavljenog službe gde radi;

Za svoj rad raportira Šefu administracije i rukovodilačkoj osoblji – GCPM-a;

Drugi detalji zadataka i obaveza će se opisati u radnom ugovoru.

Uslovi konkursa:

Kandidat/kinje koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih uslovi predviđenih prema zakonu mora imati završen:

- Srednju Školu;
- Kopiju vozačke dozvole kategorija "B";

Potrebna dokumentacija:

- Kopiju Diplome Srednje Škole;
- Rodjeni izvod;
- Kopiju vozačke dozvole, kategorija "B";
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda;
- Kopiju vozačke dozvole;
- Svaki drugi dokument od raznih trajninga, koju kandidat procenjuje važnom za ovo radno mesto, trebaju priložiti dokumentaciji;
- Dokaz o osnovnom poznavanju rada u računaru – poželjna.

Svaki aplikant mora predati svu traženu dokumentaciju prema konkursu i to:

- Punjenu aplikaciju;
- Dokaz o stručnoj spremi i profesionalnu kvalifikaciju/kopije/ overena od beležnika;

Svih kandidati koji uđu u užu listu, će se pozvati na intervju, i za datum održavanja intervjua biće na vreme obavesteni od strane određene Komisije za Intervju.

Aplikacije se mogu dobiti online i predaju se preko pošte u Administraciju GCPM-a Skenderaj od 8-15 časova.

Dokumentacija koja se priloži aplikaciji mora biti fotokopje i ista se ne vraća kandidatu.

Dokumentacija koja se ne odgovara uslovima i kriterije konkursa, kao i nekompletirana dokumentacija i ona koji dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati.

Imaju pravo da konkurišu svih državljanima Republike Kosova;

Rok za konkurisanje će biti petnaest (15) dana od dana objavljivanja konkursa u dnevnom novinu i drugim sredstvima informiranja.

Konkurs se objavljuje u oba jezika.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Kancelaria Premijera-Office of the Prime Minister

Në bazë të nevojës për krijimin e një ekipi të përkohshëm për zhvillimin e programit Kompakt ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe SHBA-së, shpallen këto pozita për angazhimin e ekspertëve:

I. Një (1) Koordinator Kombëtar
Numri referues: ZKM-ZSM-001

Gjatë zhvillimit të Programit Kompakt, secili vend i kualifikuar duhet të mobilizojë burime të konsiderueshme financiare dhe njerëzore, të dhëna dhe informacione dhe të menduarit kritik nga sektori i tij publik dhe privat dhe shoqëria civile. Koordinator Kombëtar e udhëheqë këtë proces të përpjekjeve duke menaxhuar punën e detajuar të përditshme të stafit të specializuar në Ekipin për Zhvillimin e Programit Kompakt dhe duke i angazhuar aktorët kyç në ministri dhe agjenci qeveritare, komunitetin biznesor dhe organizatat e shoqërisë civile.

Për të qenë i suksesshëm, Koordinator Kombëtar duhet të jetë në gjendje t'i menaxhojë dhe të përgjigjet ndaj presioneve nga politikanët, udhëheqësit e biznesit dhe publiku, të koordinojë rrjedha të shumëllojshme të punës komplekse, t'i delegojë detyrat duke i pasur parasysh detajet, të komunikojë në mënyrë të qartë dhe efikase dhe t'i inspirojë aktorët dhe stafin.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e menaxhimit, administratës së biznesit, administratës publike, financave apo ekonomisë, juridikut, komunikimeve apo ndonjë fushë tjetër relevante profesionale.
- Përvojë pune paraprake dhjetë (10) vjeçare apo më shumë në pozita të larta menaxhuese në subjekte të profilit të lartë apo strategjike në sektorin publik apo privat.
- Aftësi të demonstruar për menaxhim të një institucioni, programi apo projekti të madh me staf prej dhjetë apo më shumë anëtarëve dhe preferohet me një buxhet vjetor prej më shumë se 5 milionë \$.
- Shkathtësi të jashtëzakonshme udhëheqjeje dhe organizative dhe aftësi për të punuar në ekipe të mëdha të përbëra nga shumë kultura. Aftësi për performancë të mirë nën presionin e afateve përfundimtare ambicioze dhe pritjeve të larta.
- Përvoja e konsiderueshme paraprake në planifikimin e zhvillimit ekonomik apo ekzekutimin e projekteve për zhvillim ekonomik është shumë e preferueshme. Gjithashtu preferohet përvoja me organizata ndërkombëtare donatore dhe një kombinim i përvojës brenda dhe jashtë qeverisë.
- Shkathtësi të shkëlqyeshme për komunikim me shkrim dhe verbal në gjuhën angleze.

Përshkrimi i përgjegjësive kryesore:

- Koordinohet nga afër me zyrtarët e lartë të qeverisë për t'i kuptuar dhe prezantuar në mënyrë efikase prioritetet e vendit të kualifikuar në zhvillimin e Programit Kompakt.
- Shërben si pikë primare e kontaktit për shkëmbimin e informacioneve kritike operacionale ndërmjet qeverisë dhe MCC, përfshirë kuptimin e qartë dhe të plotë të procesit të zhvillimit të Kompaktit, kërkesave dhe kriterëve për investime të MCC.
- Menaxhon tërë procesin e zhvillimit të Kompaktit në emër të qeverisë, përfshirë udhëzimin për analizën fillestare dhe vlerësimin e sfidave për zhvillim ekonomik, udhëheqjen e identifikimit të koncept projekteve që do t'i adresojnë ato sfida, promovojnë zbatimin e varfërisë dhe rritjen ekonomike, koordinimin e zhvillimit dhe dizajnit të projekteve të dakorduara, të cilat i përmbushin kriteret për investime dhe kërkesat tjera të MCC.
- Rekruton staf me kualifikim të duhur dhe të specializuar për Ekipin për Zhvillimin e Programit Kompakt që është i kualifikuar në mënyrë të duhur dhe ofron udhëheqje ekzekutive, menaxhim dhe koordinim të nivelit të lartë gjatë punës së tij të përditshme.
- Krijon, ruan dhe shfrytëzon marrëdhënie efektive me zyrtarët, zyrtarët, individët dhe stafin kyç në qeveri për të siguruar shpërndarjen e informacioneve, për të siguruar zotimin e të gjitha informacioneve dhe burimeve të nevojshme dhe për të motivuar përfundimin në kohë të detyrave kritike.
- I raporton në baza periodike Presidentit, Kryeministrit apo pikës së përcaktuar politike të kontaktit (p.sh. MZHE) për t'iu ofruar në kohë përditshme në lidhje me statusin e procesit të zhvillimit të Kompaktit, marrjen e mbështetjes së nivelit të lartë dhe aprovimit për vendimet kyçe dhe për identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve.
- Angazhon në mënyrë aktive aktorët të rëndësishëm politikë, udhëheqës të biznesit privat, organizata të shoqërisë civile dhe donatorë ndërkombëtarë përgjatë procesit të zhvillimit të Kompaktit dhe shërben si përfundimtarë të dukshëm publik i përpjekjeve të qeverisë për zhvillim të Kompaktit.
- Planifikon dhe zbaton vizita periodike nga stafi dhe zyrtarët e lartë të MCC.

Niveli i përpjekjes:

Koordinatori Kombëtar duhet të jetë në dispozicion me orar të plotë gjatë procesit të zhvillimit të Kompaktit, i cili në përgjithësi zgjat dy deri në tre vjet. Roli është rigoroz dhe sfidues dhe për këtë arsye Koordinator Kombëtar nuk duhet të ketë përgjegjësi të konsiderueshme konkurruese gjatë kësaj kohe.

Stafi homolog:

Koordinatori Kombëtar do të punojë drejtpërdrejt me Udhëheqësin e Ekipit të Vendit (UEV) të MCC për vendin e kualifikuar.

II. Një (1) Ekonomist për Monitorim dhe Vlerësim
Numri Referues: OPM-ZSM-002

Gjatë zhvillimit të Programit Kompakt, secili vend i kualifikuar duhet të vlerësojë mjedisin e tij makroekonomik për t'i identifikuar fushat që premtojnë mundësi, për t'i përzgjedhur projektet që kanë gjasa t'i mbështesin nivelet e larta të rritjes ekonomike dhe t'i identifikojnë ndikimet specifike ekonomike dhe përfituesit e secilit projekt të propozuar. Ekonomisti/Udhëheqësi për Monitorim dhe Vlerësim do t'i udhëheqë këto përpjekje duke organizuar dhe menaxhuar zhvillimin e Analizës së Kufizimeve në Rritjen Ekonomike në fazën më të hershme të zhvillimit të Kompaktit dhe më vonë përmes zhvillimit të arsyetimit ekonomik për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve të propozuara dhe realizimin e vlerësimit të analizës së përfituesit dhe normës ekonomike të kthimit për projektet e dakorduara. Përfundimisht, Ekonomisti/Udhëheqësi për Monitorim dhe Vlerësim do të jetë përgjegjës për të siguruar që secili projekt në Programin Kompakt i përmbushë kërkesat strikte të MCC për rritje ekonomike dhe zbutje të varfërisë, me theks të veçantë se si kanë gjasa të ndikojnë projektet e propozuara në ekonomitë familjare të varfra dhe grupet e pafavorizuara, përfshirë gratë.

Për të qenë i suksesshëm, Ekonomisti/Udhëheqësi për Monitorim dhe Vlerësim duhet të jetë në gjendje që të punojë në bashkëpunim me ekipet ndërdisiplinore, të udhëheqë dhe organizojë ushtrime komplekse analitike, të mbledhë, sintetizojë dhe vlerësojë sasi të mëdha të të dhënave dhe

informacioneve, të nxjerrë përfundime në një mjedis pasigurie dhe afate të ngushta kohore dhe të komunikojë dhe shkruajë në mënyrë të qartë dhe efikase.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, politikave publike apo studime të ndërlidhura. Diploma master apo diploma e doktoratës është shumë e preferueshme.
- Përvojë pune tre (3) vjeçare apo më shumë në pozitë në fushën e ekonomisë, me përgjegjësi të konsiderueshme për menaxhimin e projektit dhe stafit.
- Aftësi të demonstruara për të marrë të dhëna nga institucionet vendore, si ministritë dhe agjencitë statistikore qeveritare.
- Aftësi të demonstruar për të analizuar aspektin ekonomik të projekteve zhvillimore, përfshirë realizimin e analizës së kostos-përfitimit dhe analizës së përfituesit.
- Shkathtësi të forta për softuer për analiza statistikore, siç është STATA.
- Preferohet përvoja e punës me organizatë për planifikim apo zhvillim ekonomik apo organizatë ndërkombëtare donatore.
- Përvoja në sektorin e energjisë është përparësi.

Përshkrimi i përgjegjësive kryesore:

- Udhëheqë kërkimin dhe vlerësimin për Analizën e Kufizimeve në Rritje Ekonomike për t'i identifikuar barrierat kryesore në rritjen ekonomike, investimin privat dhe zbatimin e varfërisë në vend, përfshirë marrjen dhe mbledhjen e të dhënave relevante ekonomike dhe realizimin e analizës sasiore të tyre.
- Përgatitë arsyetimin ekonomik për projektet e mundshme, përfshirë shpjegimin e qartë të mënyrave në të cilat projektet do të realizojnë rritje ekonomike dhe do të zbusin varfërinë.
- Kontribuon në zhvillimin e logjikës së detajuar të programit për projektet e propozuara, dhe për Programin Kompakt në përgjithësi, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët tjerë të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt.
- Realizon analizën e detajuar të karakteristikave ekonomike të projekteve të propozuara, përfshirë vlerësimin në detaje të kostove dhe përfitimeve të mundshme të ndërlidhura me secilin, të ndara sipas nivelit të të ardhurave, grupit social dhe gjinisë.
- Zhvillon komizë analitike, mbledh të gjitha të dhënat e kërkua dhe llogaritë Normat Ekonomike të Kthimit (ERR) për projektet e propozuara. Gjithashtu realizon vlerësim të detajuar se çfarë ndikimi do të kenë projektet e propozuara në përfituesit e synuar, me vëmendje të veçantë në ekonomitë familjare të varfra dhe grupet e pafavorizuara, përfshirë gratë.

Niveli i përpjekjes:

Pozita e Ekonomistit/Udhëheqësit për Monitorim dhe Vlerësim mund të jetë me orar të plotë dhe me shumë angazhim jo të rregullt, me kontribute më të rëndësishme gjatë identifikimit dhe arsyetimit të koncept projekteve të mundshme, arsyetimit final të projekteve të propozuara dhe llogaritjen e Normave Ekonomike të Kthimit (ERR) dhe përgatitjen dhe negocimin final të Kompaktit. Duke pasur parasysh që periudha kohore e këtij procesi të zhvillimit është e shkurtër, rekomandohet pozita me orar të plotë, në veçanti nëse kanë ekspertizë specifike në sektorin e energjisë.

Stafi homolog:

Ekonomisti/Udhëheqësi për Monitorim dhe Vlerësim do të punojë drejtpërdrejt me Ekonomistin Kryesor (EK) të MCC për vendin e kualifikuar.

III. Një (1) Specialist i Sektorit të Energjisë
Numri referues: OPM-ZSM-003

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë universitare në fushën e inxhinierisë, planifikimit, administrimit, menaxhimit të projekteve apo në ndonjë fushë tjetër relevante profesionale.
- Përvojë pune profesionale afërsisht tetë (8) vjeçare në menaxhimin e projekteve që përfshijnë sektorin e energjisë, me aftësi të demonstruar për zbatimin e projekteve të mëdha dhe komplekse në fushën e inxhinierisë brenda afateve të ngushta kohore. Njohuritë për aspekte të ndryshme të zhvillimit të projektit, përfshirë studimet e para-fizibilitetit dhe studimet e fizibilitetit, vlerësimit të kostos dhe mbikëqyrjen e dizajnit dhe/ose ndërtimit, janë të preferueshme.
- Njohuri të detajuara për politikat e sektorit të energjisë, institucionet politikë-bërëse, kompanitë energjetike dhe industrinë ndërtimore në Kosovë. Njohuritë për strategjinë, master planin dhe/ose planin për investime strategjike në sektorin e energjisë janë të preferueshme.
- Aftësi të demonstruara për të ndërvepruar në mënyrë efikase dhe konstruktive me hartuesit e politikave publike, organizatat e shoqërisë civile, ekspertët teknikë dhe të ndërtimtarisë dhe Palët e Ndikuara nga Projekti (PNP-të).
- Shkathtësi të fuqishme të komunikimit verbal dhe me shkrim.

Përshkrimi i përgjegjësive kryesore:

- Udhëheq diskutimet e detajuara për "shkaqet rrënjësore", të cilat janë shkak i kufizimeve detyruese mbi rritjen ekonomike në sektorin e energjisë, duke punuar në koordinim të ngushtë me hartuesit e politikave qeveritare, ekspertët e jashtëm, stafin e institucioneve ndërkombëtare donatore dhe aktorët tjerë.
- Në emër të Ekipit për Zhvillimin e Kompaktit, udhëheq përkufizimin e problemeve kritike me të cilat përballlet sektori i energjisë, identifikimin e strategjive të mundshme zbutëse dhe hartimin e Koncept Notës që i shpjegon këto, në përputhje me udhëzimin e MCC.
- Në emër të Ekipit për Zhvillimin e Kompaktit, udhëheq identifikimin e koncepteve të mundshme të projektit dhe hartimin e Koncept Dokumentit ku propozohen ndryshimet në politika, ato ligjore, rregullatore apo institucionale apo investimet publike apo private të nevojshme për suksesin e këtyre projekteve, në përputhje me udhëzimin e MCC.
- Udhëheq dhe menaxhon hartimin e Termave të detajuara të Referencës (TeR-ve) për studimet e fizibilitetit, vlerësimet e ndikimit mjedisor apo social, apo dizajnin paraprak që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e projekteve dhe avancimin e procesit të zhvillimit të Kompaktit.
- Ofron udhëzime të detajuara dhe konstruktive për konsulentët që mund të angazhohen për ofrimin e analizave të detajuara sektoriale apo institucionale, studime të fizibilitetit, vlerësime të ndikimit mjedisor apo social, apo dizajne paraprake, në bashkëpunim me aktorët kyç dhe MCC, dhe siguron qasjen e konsulentëve në të gjithë zyrtarët qeveritarë, institucionet, anëtarët e stafit dhe të dhënat dhe informacionet që janë të nevojshme për realizimin e punës së tyre me sukses dhe në kohë.
- Shqyrton dhe jep komente mbi rezultatet e studimeve të fizibilitetit, vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe social, apo punës për dizajnin paraprak – përfshirë planet e punës, afatet kohore dhe rezultatet thelbësore – për të siguruar se të gjitha rreziqet teknike, çështjet dhe shqetësimet adresohen në mënyrë të duhur dhe të plotë.

- Krijon, ruan dhe shfrytëzon në mënyrë efikase marrëdhëniet me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe ministritë, departamentet apo agjencitë qeveritare që janë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave, ligjeve dhe rregulloreve në sektorin e energjisë në Kosovë.
- Ndihmon në vlerësimin gjithëpërfshirës të kapacitetit teknik dhe menaxhues të ministrive, departamenteve apo agjencive qeveritare apo kompanive publike që mund të përfshihen në mbikëqyrjen, menaxhimin apo zbatimin e projekteve të propozuara.
- Shërben si pikë kryesore e kontaktit ndërmjet Ekipit të Kosovës për Zhvillimin e Kompaktit dhe Grupit të Praktikës të MCC për Energjinë dhe siguron rrjedhën adekuate të informacioneve të nevojshme për informim të duhur të MCC për progresin, çështjet dhe rreziqet.

Niveli i përpjekjes:

Pozita e Specialistit të Sektorit të Energjisë duhet të jetë ekuivalente me Orar të Plotë (FTE) gjatë procesit të zhvillimit të kompaktit.

IV. Një (1) Specialist i Zhvillimit të Sektorit Privat Numri referues: OPM-ZSM-004

Gjatë zhvillimit të një Programi Kompakt, secili vend i kualifikuar duhet të angazhojë komunitetin e biznesit në identifikimin dhe dizajnimin e projekteve në ato mënyra që përmirësojnë mjedisin biznesor, fuqizojnë rregulloret dhe institucionet, krijojnë politika të orientuara në treg, krijojnë besimin e investitorëve dhe krijojnë shërbime themelore që i mbështesin aktivitetet e biznesit privat. Specialisti i Zhvillimit të Sektorit Privat do t'i udhëheqë këto përpjekje duke organizuar, menaxhuar dhe mbështetur angazhimin me komunitetin e biznesit; duke mbledhur dhe vlerësuar të dhënat mbi sektorët kyç ekonomikë dhe konkurrueshmërinë e përgjithshme ekonomike; duke identifikuar çështjet kyçe në mjedisin biznesor që kufizojnë apo pengojnë rritjen e investimit privat apo veprimtarisë së biznesit privat; duke identifikuar mundësitë për zgjerim të veprimtarisë biznesore private nëpërmjet projekteve të propozuara të kompaktit; dhe duke dizajnuar strategji specifike për të angazhuar biznesin privat apo investitorët privatë në zbatimin apo operimin afatgjatë të projekteve të kompaktit apo tërheqjen e investimit plotësues privat për projektet e kompaktit. Përfundimisht, Specialisti i Zhvillimit të Sektorit Privat do të jetë përgjegjës për të siguruar që propozimet për projekte të vendit të kualifikuar i pasqyrojnë në mënyrë të plotë mundësitë për zgjerim të investimit privat, si në investimet specifike të financuara nga MCC-ja ashtu edhe rreth tyre, dhe për të rritur ndikimin dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë afatgjatë të Programit Kompakt.

Për të qenë i suksesshëm, Eksperti për Zhvillimin e Sektorit Privat duhet të ketë njohuri të detajuara për ekonominë e vendit të kualifikuar, njohuri të konsiderueshme për interesat dhe shqetësimet e biznesit privat dhe investitorëve privatë, të jetë në gjendje të organizojë dhe vazhdojë angazhimin me një varg të gjerë të akterëve, si dhe të jetë në gjendje të punojë bashkërisht me ekipet ndërdisiplinore.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, biznesit, financave, juridikut apo ndonjë fushë të ndërlidhur.
- Përvojë pune paraprake dhjetë (10) vjeçare apo më shumë në promovimin apo prezantimin e shqetësimeve të investitorëve privatë apo biznesit privat.
- Aftësi të demonstruara për mbledhjen, organizimin dhe analizimin e të dhënave sasiore dhe cilësore dhe informacioneve në realizimin e vlerësimeve dhe nxjerrjen e përfundimeve.
- Shkathtësi të forta organizative dhe komunikuese.
- Përvoja e punës me agjenci për planifikim apo zhvillim ekonomik, agjenci për promovim të tregtisë apo investimeve apo organizatë ndërkombëtare donatore është e preferueshme.
- Përvoja në sektorin e energjisë është përparësi.

Përshkrimi i përgjegjësive kryesore:

- Kontribuon në zhvillimin e planeve për konsultime publike dhe angazhimin e akterëve dhe udhëheq organizimin, menaxhimin dhe zbatimin e kontaktimit të bizneseve private dhe investitorëve privatë për të siguruar që merren parasysh plotësisht pikëpamjet e tyre. Mban konsultime të vazhdueshme me bizneset private, investitorët privatë, akademikët dhe zyrtarët përkatës qeveritarë përgjatë procesit të zhvillimit të kompaktit.
- Vlerëson konkurrues mërinë e përgjithshme ekonomike të vendit të kualifikuar dhe identifikon pengesat në investime private dhe zgjerimin e mundësive të biznesit privat në sektorët kritikë të ekonomisë vendore.
- Kontribuon në analizimin e çështjeve shkaktare dhe shkaqeve rrënjësore për kufizimet detyruese në rritjen ekonomike, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët tjerë të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt për të siguruar që shqetësimet dhe çështjet e bizneseve private dhe investitorëve privatë kuptohen, mblidhen dhe merren plotësisht parasysh.
- Punon nga afër me Specialistin për Përfshirje Sociale dhe Vlerësim Gjinor për të siguruar që shqetësimet dhe nevojat e ndërmarrjeve të vogla – në veçanti ato të drejtuara nga gratë apo grupet tradicionalesht të pafavorizuara – integrohen në vlerësimin e përgjithshëm të mundësive.
- Kontribuon në identifikimin dhe zhvillimin e koncepteve fillestare dhe propozimeve për projekte duke bashkëpunuar ngushtë me anëtarët tjerë të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt për të siguruar që merren parasysh mundësitë për zvogëlimin e pengesave në investime private dhe zgjerimin e veprimtarisë së biznesit privat.
- Kontribuon në zhvillimin e logjikës së detajuar të programit për projektet e propozuara dhe për Programin e përgjithshëm Kompakt duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët tjerë të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt.
- Shqyrton dhe vlerëson konceptet fillestare dhe propozimet për projekte për t'i identifikuar mundësitë shtesë për zgjerimin e investimit privat dhe veprimtarinë e biznesit privat duke përmirësuar rregulloren apo politikën apo duke përmirësuar në ndonjë mënyrë tjetër klimën e përgjithshme biznesore; duke shkëmbyer kostot e zhvillimit me investitorët privatë; duke përfshirë biznesin privat në zbatimin e projektit; duke përmirësuar stimujt për investim privat nëpërmjet investimeve të projektit; apo duke promovuar investimet paralele nga interesat e biznesit privat.

Niveli i përpjekjes:

Gjatë procesit të zhvillimit të Kompaktit, në mesatare, angazhimi i Specialistit të Zhvillimit të Sektorit Privat duhet të jetë së paku 50 për qind dhe ndoshta me orar të plotë, në veçanti nëse ka ekspertizë për sektorin. Kontributet më të mëdha nga Specialisti i Zhvillimit të Sektorit Privat do të jenë gjatë zhvillimit dhe dizajnit të propozimeve specifike të projekteve, në veçanti nëse është duke u shqyrtuar pjesëmarrja private në njërin nga projektet (që pritet të jetë një përpjekje e konsiderueshme).

Stafi homolog:

Specialisti i Zhvillimit të Sektorit Privat do të punojë drejtpërdrejt me një anëtar të Divizionit të Financave, Investimeve dhe Tregtisë (FIT) të MCC.

V. Një (1) Specialist për Përfshirje Sociale dhe Integrim Gjinor Numri referues: ZKM-ZSM-005

Gjatë zhvillimit të Programit Kompakt, secili vend i kualifikuar duhet t'i analizojë dallimet dhe pabarazitë gjinore dhe t'i integrojë plotësisht çështjet sociale dhe gjinore në procesin e tij për identifikimin, zhvillimin dhe dizajnimin e projekteve të mundshme. Specialisti për Përfshirje Sociale dhe Integrim Gjinor do t'i udhëheqë këto përpjekje nëpërmjet organizimit, menaxhimit dhe vazhimit të angazhimit me ekspertët dhe organizatat që përfaqësojnë interesat e të varfërve, grupeve sociale të pafavorizuara dhe grave; mbledhjes dhe vlerësimit të të dhënave në lidhje me dimensionet sociale dhe gjinore të zhvillimit ekonomik; identifikimit të kufizimeve kyçe ligjore, sociale dhe kulturore që e pengojnë shpërndarjen e barabartë të përfitimeve nga zhvillimi ekonomik; identifikimit të mundësive për zvogëlimin e barrierave dhe zgjerimin e pjesëmarrjes së të varfërve, grupeve sociale të pafavorizuara dhe grave në zhvillimin ekonomik nëpërmjet projekteve të propozuara të Kompaktit; zhvillimit të strategjive për integrimin e shqetësimeve relevante sociale dhe gjinore në projektet e propozuara; dhe analizimit të ndikimit të mundshëm të projekteve të propozuara në grupe të ndryshme përfituese.

Për të qenë i suksesshëm, Specialisti për Përfshirje Sociale dhe Integrim Gjinor duhet të kenë njohuri të detajuara për mjedisin ligjor, social dhe kulturor të vendit të kualifikuar; njohuri të konsiderueshme për përvojat e të varfërve, grupeve sociale të pafavorizuara dhe grave; të jetë në gjendje të organizojë dhe mbështes angazhimin me një varg të gjerë të akterëve dhe të jetë në gjendje të punojë në bashkëpunim me ekipet ndërdisiplinore.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në juridik, politika publike apo shkenca sociale, me fokus kryesor në çështjet gjinore, siç janë antropologjia, sociologjia, studimet e grave, apo zhvillimi i komunitetit. Diploma master apo diploma e doktoraturës është shumë e preferueshme.
- Përvojë pune dhjetë (10) vjeçare apo më shumë në vlerësimin, promovimin ose mbrojtjen e çështjeve që lidhen me të varfërit, grupet sociale të pafavorizuara apo gratë në një kontekst të lidhur me shqetësimet për zhvillimin ekonomik.
- Njohuri të detajuara për politikën, ligjet dhe rregulloret në lidhje me shqetësimet për përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore në vendin e kualifikuar, me fokus të veçantë në mjedisin e politikave dhe mjedisin institucional, përfshirë çështjet në lidhje me statusin juridik me të cilat përballen të varfërit, grupet sociale të pafavorizuara dhe gratë.
- Aftësi e demonstruar për integrimin e çështjeve sociale dhe gjinore në zhvillimin dhe dizajnimin e projekteve të mëdha për zhvillim ekonomik dhe infrastrukturë.
- Përvoja e punës me Organizata Joqeveritare (OJQ) në lidhje me shqetësimet e të varfërve, grupeve sociale të pafavorizuara apo grave, organizata kombëtare për gratë apo grupet e pafavorizuara, agjenci relevante qeveritare apo partnerë zhvillimorë ndërkombëtarë është e preferueshme.

Përshkrimi i përgjegjësive:

- Kontribuon në identifikimin e akterëve relevantë dhe zhvillimin e planeve për konsultime publike dhe angazhimin e akterëve, dhe më pas udhëheq organizimin, menaxhimin dhe zbatimin e komunikimit me ekspertët dhe organizatat që përfaqësojnë interesat e të varfërve, grupeve të pafavorizuara sociale dhe grave, duke përfshirë organizatat që përfaqësojnë bizneset e grave. Mban konsultime të vazhdueshme me ekspertët dhe organizatat të tilla, institucione akademike dhe agjenci relevante qeveritare gjatë procesit të zhvillimit të kompaktit.
- Identifikon dhe vlerëson ndikimin e pengesave ligjore, institucionale, sociale dhe kulturore që kufizojnë pjesëmarrjen ekonomike ose pengojnë uljen e varfërisë në mesin e të varfërve, grupeve të pafavorizuara sociale dhe grave.
- Kontribuon në identifikimin dhe zhvillimin e koncepteve fillestare dhe projekt-propozimeve, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt për të siguruar që merren parasysh mundësitë për të zvogëluar barrierat dhe për të zgjeruar pjesëmarrjen e të varfërve, grupeve të pafavorizuara sociale dhe grave në zhvillim ekonomik.
- Kontribuon në zhvillimin e një logjike të detajuar të programit për projektet e propozuara dhe për programin e përgjithshëm të kompaktit, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt.
- Gjatë fazës së zhvillimit të projektit, vlerëson përshatshmërinë teknike dhe ofron rekomandime teknike dhe inpute që lidhen me çështje sociale dhe gjinore në çdo studim të fizibilitetit ose të dizajnit, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social, planin e veprimtimit të zhvendosjes ose planin e menaxhimit mjedisor dhe social (përfshirë çdo plan të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ose çdo plan lehtësues për rreziqet që lidhen me punën e fëmijëve, trafikimin e qenieve njerëzore, ose me HIV/AIDS), përfshirë çdo vlerësim gjinor ose plan të integritimit gjinor.
- Kontribuon në zhvillimin e Planit të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V) që përfshin tregues dhe të dhëna të ndara siç duhet për moshën, gjininë dhe faktorët tjerë social të rëndësishëm në mënyrë që ndikimi të gratë dhe të grupet e tjera të pafavorizuara të mund të gjurmohet siç duhet.
- Siguron që të gjitha kërkesat e Piketave të MCC për Integrim Gjinor dhe Procedurat Operative për Zhvillimin e Kompaktit janë përbushur gjatë procesit të zhvillimit të kompaktit.

Niveli i përpjekjes:

Mesatarisht, roli i Specialistit të Përfshirjes Sociale dhe Integritimit Gjinor duhet të zë 50 për qind të ekuivalentit me kohë të plotë (FTE) gjatë procesit të zhvillimit të Kompaktit. Kontributet më të mëdha nga Specialisti i Përfshirjes Sociale dhe Integritimit Gjinor do të nevojiten gjatë zhvillimit të logjikës së programit; shqyrtimit të projekteve të mundshme; dhe përpunimit, zhvillimit të mëtejshëm dhe dizajnit të projekteve të propozuara.

Stafi homolog:

Specialisti i Përfshirjes Sociale dhe Integritimit Gjinor do të punojë drejtpërdrejt me një anëtar të departamentit të MCC për Integrim Gjinor dhe Social (GSI). MCC gjithashtu mund të sigurojë një konsulent ndërkombëtar me përvojë për të mbështetur punën e zhvillimit të kompaktit.

VI. Një (1) Specialist i Performancës Sociale dhe Mjedisit (ESP) Numri referues: ZKM-ZSM-006

Gjatë zhvillimit të Programit Kompakt, secili vend i kualifikuar duhet të vlerësojë çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet në procesin e identifikimit, zhvillimit dhe hartimit të projekteve të mundshme. Specialisti Mjedisor dhe Social do t'i udhëheqë këto përpjekje përmes organizimit, menaxhimit dhe mbështetjes së angazhimit me ekspertët dhe organizatat që përfaqësojnë interesat kombëtare brenda sektorëve të mjedisit dhe social. Kjo do të përfshijë mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave në lidhje me dimensionet mjedisore dhe sociale të zhvillimit ekonomik; identifikimin e kufizimeve kyçe mjedisore dhe sociale që pengojnë përfitimet afatgjata dhe të qëndrueshme të projekteve të propozuara; dhe identifikimin e mundësive për të përmirësuar ose zgjeruar rezultatet e projektit përmes ndërhyrjeve mjedisore ose sociale.

Për më tepër, Specialisti do të sigurojë që konsideratat e duhura për performancën mjedisore dhe sociale, siç përcaktohen në Standardet e Performancës së IFC-së, Udhëzimet e Mjedisit të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), dhe Legjislacionin Mjedisor dhe Social të Qeverisë së Kosovës (OK) përfshihen në studimet dhe vlerësimet e kryera gjatë procesit të zhvillimit të kompaktit. Në këtë drejtim, Specialisti Mjedisor dhe Social i Kosovës do të luajë një rol kryesor në planifikimin dhe hartimin e programit të kompaktit.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në shkencë natyrore, politika/planifikim/menaxhim të burimeve natyrore ose mjedisore, inxhinieri ose fushë tjetër profesionale përkatëse.
- Përafërsisht tetë ose më shumë vjet përvojë profesionale me përgatitjen, rishikimin, menaxhimin ose mbikëqyrjen e lejeve mjedisore ose vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe social. Preferohet përvoja paraprake në punën me projekte të financuara nga organizata ndërkombëtare ose donatorë ndërkombëtarë.
- Njohuri mbi ligjet dhe rregulloret mjedisore të QK-së, veçanërisht ato që lidhen me vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe social, blerjen e tokës dhe zhvendosjen, shëndetin dhe sigurinë publike, konsultimet publike dhe me çështje gjinore.
- Përvojë me standardet, udhëzimet dhe politikën mjedisore nga organizatat ndërkombëtare ose donatorët ndërkombëtarë. Preferohen njohuritë mbi Politikën Operative të Bankës Botërore (OP) 4.12 dhe/ose Standardet e Performancës së Korporatës Ndërkombëtare të Financave (IFC).
- Aftësi të dëshmuar për të ndërvepruar në mënyrë konstruktive me politikë-bërësit publikë, organizatat e shoqërisë civile, ekspertë teknikë dhe të inxhinierisë dhe palë të tjera të prekura nga kompakti.

Përshkrimi i përgjegjësisë:

- Në emër të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt, udhëheq identifikimin dhe dokumentimin e "shkaqeve rrënjësore" mjedisore dhe sociale që mund të mbështesin kufizimet detyruese të identifikuar gjatë fazës së vlerësimit të vendit dhe identifikimin dhe dokumentimin e rreziqeve të mundshme mjedisore dhe sociale, çështjeve dhe shqetësimeve që lidhen me konceptet e projektit të propozuar.
- Zhvillon dhe rishikon Termat e Referencës (TeR) për çdo studim të fizibilitetit, vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe social, ose punë paraprake të hartimit për të siguruar që ato do të jenë në përputhje me të gjitha politikën, ligjet dhe rregulloret përkatëse mjedisore dhe sociale të QK-së; Udhëzimet Mjedisore të MCC; dhe, çdo pjesë të rëndësishme të Standardeve të Performancës së Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC).
- Rishikon dhe komenton mbi rezultatet e studimeve të fizibilitetit, vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe social, ose punëve paraprake të dizajnit për të siguruar që të gjitha rreziqet, çështjet dhe shqetësimet mjedisore të trajtohen në mënyrë të duhur dhe të tërësishme.
- Krijon, ruan dhe shfrytëzon në mënyrë efektive marrëdhëniet me ministritë përkatëse, departamentet dhe agjencitë (p.sh. MMPH, AKMM, DKA, AKKEE, MSH, IKSH, etj.) ose agjencitë e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave mjedisore dhe sociale, ligjeve dhe rregullore në Kosovë.
- Ndihmon në vlerësimin gjithëpërfshirës të kapaciteteve të menaxhimit mjedisor dhe social të çdo ministrie, departamenti ose agjencie qeveritare ose të ndonjë kompanie publike që mund të përfshihen në mbikëqyrjen, menaxhimin ose zbatimin e ndonjë projekti të propozuar.
- Ndihmon në organizimin dhe menaxhimin e konsultimeve periodike me ekspertë, palë të interesuara dhe palë të mundshme të prekura nga projekti, sipas nevojës, dhe të përshtatshme për të siguruar shkëmbimin transparent të informacioneve në lidhje me procesin e zhvillimit kompakt dhe për çdo koncept të projektit të propozuar.
- Shërben si pikë kryesore e kontaktit midis Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt të QK dhe ekipit të Performancës Mjedisore dhe Sociale të MCC (ESP), dhe siguron rrjedhën e duhur të informacionit siç është e nevojshme për ta mbajtur MCC mirë të informuar për progresin, çështjet dhe rreziqet.

Niveli i përpjekjes:

Mesatarisht, roli i Specialistit Mjedisor dhe Social duhet të zëjë afërsisht 50-75 për qind të një ekuivalentit me kohë të plotë (FTE) gjatë procesit të zhvillimit të kompaktit. Kontributet më të mëdha nga Specialisti do të nevojiten gjatë hulumtimit dhe analizës së projekteve të mundshme; dhe përpunimit, zhvillimit të mëtejshëm dhe hartimit të projekteve të propozuara. Nëse konsulentët e jashtëm janë të angazhuar të kryejnë studime të fizibilitetit dhe vlerësime të ndikimit në mjedis, ky nivel i angazhimit mund të rritet pasi pranohen raporte dhe rezultate të tjera.

**VII. Një (1) Specialist i Prokurimit
Numri i Referencës: OPM-ZSM-007**

Specialisti i Prokurimit, gjatë zhvillimit të kompaktit, do të jetë përgjegjës për ofrimin e këshillave dhe udhëheqjes së përgjithshme për të gjitha çështjet e lidhura me prokurimin lidhur me hartimin dhe përgatitjen e projektit, si dhe planifikimin lidhur me zbatimin dhe qëndrueshmërinë. Derisa projektet identifikohen, kjo do të përfshijë bashkëpunimin e ngushtë me specialistët teknikë të Ekipit për Zhvillimin e Programit Kompakt për të planifikuar prokurime të kompaktit, për të punësuar agjentë të prokurimit dhe për të zbatuar politikën dhe udhëzimet e zbatueshme të prokurimit MCC në zhvillimin e kompaktit.

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë universitare në administrim biznesi, administratë publike, financa, zhvillim ndërkombëtar ose fushë tjetër përkatëse.
- Përvojë në menaxhimin e projektit.
- Të paktën 5-7 vjet përvojë pune në funksione të lidhura me prokurimin, mundësisht të tilla që ndihmohen nga partnerët kryesorë të zhvillimit.
- Ekspert në procedurat e prokurimit për mallra dhe shërbime dhe në praktikën më të mirë ndërkombëtare.
- Shkathtësi në sistemet e të dhënave dhe informacioneve.
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit me shkrim dhe verbal në gjuhën angleze.

Përshkrimi i përgjegjësisë:

- Ofron mbështetje të përgjithshme lidhur me prokurimin për ekipin qendror dhe ministritë përkatëse të QK të ngarkuara me zhvillimin e kompaktit dhe projektet/nënprojektet e mundshme me fokus në sistemin, logjistikën, aspektet teknike, procedurale dhe ligjore të prokurimit.
- Ofron këshilla strategjike të prokurimit për planifikimin e projektit dhe përgatitjen për anëtarët e ekipit qendror.
- Koordinon funksionet e ekipit qendror dhe agjentit të prokurimit sapo të angazhohen në zbatimin e programit kompakt, duke përfshirë identifikimin e nevojave fillestare të prokurimit dhe organizimin e operacioneve të prokurimit.
- Harton sistemin e përcjelljes së ekzekutimit të kontratave të prokurimit, duke siguruar që ofertat të jepen në mënyrë transparente dhe në kohë, regjistrimin e transaksioneve dhe raportimin për të gjitha aktivitetet e prokurimit.
- Rishikon dhe miraton pakot e prokurimit të propozuara për projektet/nën-projektet individuale për pajtuueshmërinë e tyre me procedurat e përcaktuara.
- Ndërmerr kontroll në vend dhe të rastit dhe auditon procedurat e prokurimit dhe ekzekutimet aktuale të kontratave të prokurimit.
- Përgatit dhe krijon manualin e operimeve të prokurimit, sistemin e kundërshtimit të vendimeve për oferta, proceset e prokurimit, planet e prokurimit, raportet e performancës së prokurimit dhe dokumentet e tjera të nevojshme të prokurimit, me agjentin e prokurimit, sipas rastit, për programin kompakt.
- Mbështet stafin e ekipit qendror në ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të procesit të prokurimit.
- Lehtëson përgatitjen e stafit teknik dhe dorëzimin e dokumenteve të nevojshme që përcaktojnë nevojat e prokurimit tek Agjenti i prokurimit.
- Miraton vendimet e prokurimit siç përcaktohen në Kërkesat e Miratimit të Udhëzimeve të Prokurimit të MCC.
- Lehtëson kërkesat për miratime nga MCC për vendimet e prokurimit ashtu siç kërkohen në Kërkesat e Miratimit të Udhëzimeve të Prokurimit të MCC.

Niveli i përpjekjes:

Mesatarisht, roli i Specialistit të Prokurimit duhet të zëjë ekuivalent me gjysmë orari ose me orar të plotë (FTE) gjatë procesit të zhvillimit kompakt. Kontributet më të mëdha nga Specialisti i prokurimit do të nevojiten gjatë kujdesit dhe vlerësimit të duhur të projekteve të mundshme; negociatave kompakte dhe nënshkrimit; dhe mobilizimit të njësisë së re përgjegjëse, veçanërisht të funksionit të prokurimit dhe punësimit të Agjentit të Prokurimit.

**VIII. Një (1) Specialist i Financave
Numri referues: OPM-ZSM-008****Kualifikimet:**

- Diplomë bachelor në kontabilitet/financa ose fushë përkatëse;
- Të paktën pesë (5) ose më shumë vjet përvojë progresive në menaxhim të financave, mundësisht në zhvillimin ndërkombëtar dhe me organizatat qeveritare dhe agjencitë e donatorëve; preferohet niveli i masterit;
- Përvojë në menaxhimin e proceseve të menaxhimit financiar, mundësisht me ndihmën e partnerit zhvillimor;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, koordinimi; aftësi të demonstruara për të bashkëpunuar dhe bashkëpunuar me njerëz nëpër departamente, sektorë dhe institucione;
- Aftësi të mira kompjuterike për të përfshirë aplikacionet e Microsoft Office (MS Word, MS Excel, MS PowerPoint, etj.) dhe aftësi për të përdorur dhe shfrytëzuar internetin.
- Rrjedhshmëri në të shkruar dhe të folur në gjuhën angleze.

Përshkrimi i përgjegjësisë kryesore:

- Shërben si Pikë Kontakti për rishikimin dhe hetimin financiar dhe kontabël të MCC në lidhje me fondet e Grantit të IE-së të menaxhuara nga Qeveria e Kosovës; bashkëpunon ngushtë me Drejtorin e Shërbimeve Financiare të Programit të MCC;
- Shërben si kujdestar kryesor i të gjitha listave të pagave, kontabilitetit dhe regjistrave të menaxhimit financiar;
- Rishikon regjistrin e orëve të punës, listën e pagave dhe bën rregullimet e kërkuara të taksave, paradhënëve, fondit të pensionit;
- Rishikon dhe verifikon një gamë të transaksioneve (përfshirë disbursimet, transferimet, etj.) dhe siguron që Parimet e Kostos të MCC dhe udhëzimet e tjera të financave dhe kontabilitetit të MCC janë respektuar siç duhet, si dhe dokumentacioni është aktual dhe i saktë për të mbështetur raportimin dhe aktivitetet e auditimit;
- Monitoron buxhetet dhe fluksin ditor të parasë së gatshme duke siguruar që çështjet e shpenzimeve të larta/shpenzimeve të ulëta janë parashikuar dhe se masat përmirësuese janë ngritur për menaxhmentin;
- Mbikëqyr përgatitjen dhe organizimin e dokumentacionit të financave dhe kontabilitetit për buxhetimin, raportimin dhe aktivitetet e auditimit, duke siguruar që informacioni është i saktë dhe i gjurmueshëm;
- Konsolidon dhe mirëmban dokumentacionin për çështjet dhe praktikën më të mira për të mbështetur aktivitetet e përmirësimit të procesit; dhe
- Është i gatshëm për të kryer detyra dhe përgjegjësi të tjera për zyrën jashtë orarit të punës.

Rezultatet

- Është plotësuar regjistrin i orëve të punës, të dhënat mbi pagat dhe informatat mbi mbajtjet në burim, si dhe është realizuar regjistrimi dhe procesimi i pagave dhe mbajtjeve të zbatueshme për stafin dhe këshilltarët;
- Është përgatitur dokumentacioni për menaxhim financiar dhe kontabilitet për buxhetim, raportim dhe aktivitetet e auditimit, duke siguruar që informatat janë të sakta dhe të gjurmueshme
- Është bërë mirëmbajtja dhe renditja e dosjeve të të gjithë dokumentacionit mbështetës për të gjitha aktivitetet përgjegjëse të menaxhimit financiar; janë vënë në dispozicion sipas kërkesës;
- Të gjitha kërkesat e MCC për të dhëna për të mbështetur llogaridhënie dhe mbikëqyrjen e menaxhimit financiar.

Stafi homolog:

SMF (Specialisti për Menaxhimin e Financave) do të punojë drejtpërdrejt me Drejtorin e PFS-së pranë MCC për Programin Kompakt.

**INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT NË LIDHJE ME APLIKIMIN
PROCEDURAT**

Zyra e Kryeministrit ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët për pozitën e lartpërmendur duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV
- Letër motivimi.
- Dokumentacionin e paraparë për sa i përket punësimit (dëshmi të kualifikimit profesional, të përvojës së punës, referencat etj. Diplomën e fituara jashtë vendit duhet të vërtetohen nga MASHT-i).
- Certifikatë (dëshmi) se nuk është nën hetim.
- Shtetas i Kosovës (kopja e pasaportës ose e letërnjoftimit).

Konkursin me të dhënat e aplikimit mund ta gjeni në ueb faqen: <http://www.rks-gov.net/pm/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në adresën elektronike e-mailin zyrtar personeli.zkm@rks-gov.net

Dokumentacioni i pakompletuar me informatat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kohëzgjatja e kontratës për angazhimin e ekspertëve është 6 muaj.

Pagesa për angazhimin e ekspertëve është e negociueshme.

Afati i fundit për të aplikuar është nga 03 /07/2020 deri më 13 /07/2020.

Kërkesat e dërguara pas afatit të fundit për aplikim nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutem thirrni në këtë numër: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

Na osnovu potrebe za stvaranjem privremenog tima za razvoj kompaktnog programa između vlade Kosova i SAD-a, objavljuju se slobodna mesta za sledeće pozicije stručnjaka:

I. Jedan (1) Nacionalni koordinator
Referentni broj: ZKM-ZSM-001

Tokom razvoja kompaktnog programa svaka zemlja koja ispunjava uslove mora mobilisati značajne finansijske i ljudske resurse, podatke i informacije i kritičko razmišljanje iz svog javnog sektora, privatnog sektora i civilnog društva. Nacionalni koordinator vodi ove napore kroz upravljanje detaljnim svakodnevnim radom specijalizovanog osoblja u Timu za razvoj kompaktnog programa i angažovanjem ključnih aktera iz vladinih ministarstava i agencija, poslovne zajednice i organizacija civilnog društva.

Da bi bio uspešan, nacionalni koordinator mora biti u stanju upravljati i odgovarati na pritiske političara, poslovnih lidera i javnosti; koordinisati više tokova složenog rada; delegirati zadatke bez gubitka detalja; komunicirati jasno i efikasno; i nadahnuti i motivisati aktere i osoblje.

Kvalifikacije:

- Akademski stepen menadžmenta, poslovne administracije, javne uprave, finansija ili ekonomije, prava, komunikacija ili druge relevantne stručne oblasti.
- Deset (10) ili više godina prethodnog iskustva na rukovodećim pozicijama u strateškom ili javnom sektoru visokog profila ili privatnom entitetu.
- Demonstrirana sposobnost upravljanja velikom institucijom, programom ili projektom sa osobljem od deset ili više članova i, po mogućnosti, budžetom većim od 5 miliona dolara godišnje.
- Izuzetne liderske i organizacione veštine i sposobnost rada u velikim, multikulturalnim timovima. Sposobnost dobrog rada pod pritiskom ambicioznim rokovima i visokim očekivanjima.
- Velika prednost se daje značajnom prethodnom iskustvu rada na planiranju ekonomskog razvoja ili izvršavanju projekata ekonomskog razvoja. Takođe je poželjno iskustvo rada sa međunarodnim donatorskim organizacijama i kombinacija iskustva unutar i izvan vlade.
- Odlične veštine pismenog i usmenog komuniciranja na engleskom jeziku.

Opis glavnih odgovornosti:

- Bliska koordinacija sa visokim vladinim službenicima radi razumevanja i efikasnog predstavljanja prioriteta države koja ispunjava uslove u razvoju kompaktnog programa.
- Primarna tačka kontakta za razmenu kritičnih operativnih informacija između Vlade i MCC-a, uključujući razvoj jasnog i celovitog razumevanja procesa razvoja kompaktnog programa, zahteva i kriterijuma investicija.
- Upravljanje celokupnim procesom razvoja kompaktnog programa u ime Vlade, uključujući vođenje početne analize i procene izazova ekonomskog razvoja; vodeći identifikaciju koncept projekata koji će rešiti te izazove, promovisati smanjenje siromaštva i povećati ekonomski rast; koordinacija razvoja i dizajna dogovorenih projekata koji zadovoljavaju MCC-ove kriterijume investicija i druge zahteve.
